www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 150

Tiranë – E mërkurë, 10 gusht 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 530, datë 20.7.2016	Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve.....	11559

VENDIM
Nr. 530, datë 20.7.2016

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË PROJEKTIMIT TË ÇERDHEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Këto standarde janë të detyrueshme në projektimin e çerdheve publike apo private, që do të ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohen institucionet shtetërore dhe subjektet private të përfshira në procesin e projektimit, miratimit të lejeve të ndërtimit dhe inspektimit të çerdheve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

STANDARDE
PËR PROJEKTIMIN E ÇERDHEVE

1. HYRJE

1.1 Objektivat

Ky Standard ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të çerdheve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Këto standarde janë parashikuar si për çerdhet e sektorit publik, ashtu edhe për çerdhet e sektorit privat.
Dokumenti ka për qëllim që të shërbejë si referencë për projektuesit e çerdheve dhe ndërtesave të shërbimit edukativ dhe social me interes të gjerë publik. Dokumenti përcakton dhe përshkruan hapësirat e nevojshme sipas llojit, madhësisë dhe specifikimeve në përputhje me standardet europiane për çerdhet në zonat urbane dhe ato rurale të Shqipërisë.
Këto standarde bëjnë të mundur që të krijohet një kuptim jo vetëm rreth hapësirave të nevojshme fizike të çerdhes, por edhe rreth faktorëve që ndikojnë në projektimin e tyre dhe cilësinë e mjedisit që duhet të arrihet brenda dhe rreth ndërtesave.
Standardet përfshijnë të dhënat rreth të gjitha llojeve të hapësirave të çerdhes: hapësirave edukative mësimore, hapësirave administrative dhe hapësirave të jashtme për aktivitete, si: hapësirat për lojë dhe parkim. Këto standarde mund të përdoren për qëllime të ndryshme dhe për nivele të ndryshme, duke përfshirë:

- Projektimin e çerdheve të reja;
- Projektimin e çerdheve në objekte me përdorim miks;
- Projektimin e zgjerimeve të çerdheve ekzistuese;
- Vlerësimin dhe përmirësimin e hapësirave të çerdheve ekzistuese;
- Studimin e orendive dhe pajisjeve të çerdheve, si dhe furnizimin me to;
- Bazën referuese për studime rreth shfrytëzimit dhe efikasitetit të ndërtesave.

Përveç kësaj, në këto standarde përfshihen përcaktime për nivelet më të larta dhe më të ulëta dhe rreth projektimit të hapësirave edukuese dhe atyre pritëse të ndërtesave edukative sociale, duke marrë parasysh nevojën për përshtatshmëri dhe fleksibilitet në të ardhmen, si dhe efikasitetin në kosto. Në këtë mënyrë, standardet e paraqitura synojnë që të japin një kontribut thelbësor për projektimin e mirë të ndërtesave të çerdheve.

1.2 Si të shfrytëzohen këto standarde

Standardet e paraqitura të konsiderohen të detyrueshme për çerdhet e reja ose gjatë rikonstruksionit të tyre. Këto standarde nuk aplikohen në çerdhet ekzistuese përveçse në rastin kur ato hyjnë në procesin e rikonstruksionit.

Gjithashtu, skicat dhe vizatimet e hapësirave tipike edukative të përfshira në këto standarde nuk kanë për qëllim që të kufizojnë projektuesit nga ofrimi i alternativave dhe zgjidhjeve të tjera për forma (dimensione dhe sipërfaqe) dhe rregullime të këtyre hapësirave në kuadër të kërkesave të njëjta, të cilat tejkalojnë normat minimale të evidentuara në këtë material.

1.3 Përmbledhja e temave

Përmbajtja e standardeve është e ndarë në dy kategori: (i) konceptet e përgjithshme dhe ato specifike, parametrat dhe normat, dhe (ii) përmbledhjet teknike me modele dhe udhëzime për çdo lloj hapësire dhe për hapësirat e jashtme dhe të brendshme. Kjo ndarje i mundëson projektuesit/përdoruesit që të mbledhë informacione në dy nivele:

- Të dhënat dhe udhëzimet e përgjithshme:
  - Konceptet e projektimit.
  - Normat e përgjithshme.

- Karakteristikat specifike, modelet e detajuara, të dhënat dhe udhëzimet:
  - Parametrat specifike.
  - Udhëzimet dhe modelet për hapësirat e brendshme.
  - Udhëzimet dhe modelet për hapësirat e jashtme.

1.4 Modelet (llojet) dhe fletët e përmbledhjes teknike

Në çdo fletë të përmbledhjes teknike paraqiten të gjitha standardet, parametrat dhe elementet e nevojshme për hapësirat e brendshme duke përfshirë:

- Dimensionet dhe sipërfaqet që korrespondojnë me ato të planeve të çerdhes.
- Kërkesat për hapësira dhe aktivitete.
- Lidhjet me hapësirat e tjera të çerdhes dhe qasjet e nevojshme.
- Lista e pajisjeve sipas standardit me propozime për instalim/pozicionim.
- Kërkesat për hapësirë dhe skema funksionale.

Ky dokument do të përditësohet kohë pas kohe për të pasqyruar politikat dhe zhvillimet e reja apo të korrigjuara dhe kërkesat e parashtruara nga ministritë e linjës apo institucione të tjera të interesuara.

1.5 Shfrytëzuesit e standardeve

Ky dokument ka për qëllim që t'iu shërbejë të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të çerdheve apo në rinovimin e ndërtesave ekzistuese të çerdheve. Këtu përfshihen:

- Të gjithë profesionistët që kanë të bëjnë me projektimin dhe ndërtimin e ndërtesave të çerdheve, duke përfshirë: organizatat projektuese, kompanitë konsulente, arkitektët, inxhinierët, si dhe profesionistët e tjerë të projektimit dhe ndërtimit.
- Ministritë, administratat vendore me drejtoritë përkatëse, administratat e tjera publike apo private, drejtorët e çerdheve, këshillat administrativë, administratorët dhe kujdestartët.

2. PËRKUFIZIME TË PËRGJITHSHME

2.1 Termat dhe përkufizimet

Çerdhja - është një qendër që mundëson shërbim edukativ, social dhe shëndetësor me interes të gjerë publik që bashkitë ose subjektet private iu ofrojnë fëmijëve dhe familjeve të tyre, e cila ka për qëllim që të ndihmojë në mirërritjen dhe edukimin e fëmijës, në formimin e personalitetit të tij, sigurimin e shëndetit fizik dhe mendor të tij, si dhe socializimin.

Çerdhja - frekuentohet nga fëmijë të moshës deri në 3 vjeç.

Asnjë fëmijë nuk diskriminohet nga frekuentimi i çerdhes si pasojë e paaftësisë fizike, gjinisë, racës apo etnisë.

Sipërfaqe Bruto e Dyshemesë (SBD) – Tërësia e sipërfaqes së shfrytëzimit duke përfshirë muret e brendshme. SBD përfshin zonën që nevojitet për pajisjet, dollapët e përhershëm dhe instalimet elektrike dhe hidraulike.

Kapaciteti– Numri total i fëmijëve që lejohet për çdo grup fëmijësh sipas moshës.

Dhomë– Zona të përcaktuara nga ana arkitektonike ku mblidhet çdo grup fëmijësh. Dhomat mund të ndahen me mure ndarëse apo mure të pjesshme që mundësojnë lidhje të kontrolluara për nga ana pamore apo akustike me grupet e tjera. Pamja e brendshme e një dhome të këtyre qendrave është ndryshe nga ajo e klasës tradicionale të kopshteve.

Korridor pa krye – Është një korridori ku është e mundshme dalja vetëm në një drejtim.

Krevat evakuimi me rrota – Krevat me rrota që shërben për evakuimin e fëmijëve në rast zjarri (në përgjithësi kemi 1 krevat evakuimi çdo 4 fëmijë).

Fëmijë në Grupin I(Latantët)– Fëmijët deri në 12 muajsh.

Fëmijë në Grupin II (Motakë ose të vegjël) –Fëmijët nga 12 deri 24 muajsh.

Fëmijë në Grupin III (Të mëdhenj) –Fëmijët nga 24 deri 36 muajsh.

Në përcaktimet e mëposhtme Grupi II dhe III do të konsiderohen si një grup i vetëm me dy nëngrupe kryesore.

3. STANDARDET URBANE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT

3.1 Pozicionimi

- Çerdhet duhet të pozicionohen mundësisht afër zonave të banimit dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme nga popullata e interesuar për shërbimin.

- Pozicionimi duhet të koordinohet me struktura të tjera që kanë të bëjnë me shërbimet sociale ose institucionet arsimore parashkollore.
- Karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit duhet të sigurojnë një përdorim të përshtatshëm dhe të rehatshëm të çerdhes në çdo stinë.
- Materialet e përdorura për ndërtimin dhe mobilimin e mjediseve të çerdhes duhet të jenë jo të dëmshme për fëmijët (anti bakteriale dhe anti alergjike)
- Çerdhet duhet të aksesohen të paktën nga një rrugë minimalisht me dimensione trup rruge 10(dhjetë) metra të ndara si vijon: *1.5m trotuar : 7m karexhatë : 1.5m trotuar.*



Pamje e marrë nga VKM nr.628, Dt. 15.07.2015, "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve".

- Distancat e ndërtimeve të ndryshme nga kufiri i pronës së çerdhes duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e VKM. Nr. 408, Dt. 13.05.2015, Neni 34, Pikat 2, 3 dhe 5.

**Distanca për çerdhet matet nga kufiri i pronës ku është ngritur çerdhja dhe jo nga muri i ndërtesës së çerdhes.*

3.2 Normat minimale të pronës për ndërtimin e çerdhes

- Sipërfaqja totale e pronës për ndërtimin e çerdhes duhet të llogaritet të paktën 40 m^2/fëmijë, gjithsesi jo më pak se 1500 m^2 në total.

- Koeficienti i shfrytëzimit duhet të jetë jo më shumë se 35%.

- Dimesionimi i hapësirave të ndërtimit (jo të pronës) duhet të marrë në konsideratë një minimum prej 7.60 m^2 për latantët dhe 8 m^2 për Motakët dhe të Mëdhenjtë.

3.3 Karakteristikat organizative

Ndarja e fëmijëve në grupe bëhet në bazë të grup moshave:

- Nëse kapaciteti i çerdhes është 30 vende, grupi i parë duhet të ketë 6 fëmijë më të vegjël se 1 vjeç; grupi i dytë duhet të ketë12 fëmijë nga 1 - 2 vjeç dhe grupi i tretë 12 fëmijë nga 2 -3 vjeç.
- Nëse kapaciteti i çerdhes është 45 vende, grupi i parë duhet të ketë 9 fëmijë më të vegjël se 1 vjeç; grupi i dytë duhet të ketë18 fëmijë nga 1 - 2 vjeç dhe grupi i tretë 18 fëmijë nga 2 -3 vjeç.

- Nëse kapaciteti i çerdhes është 60 vende: grupi i parë duhet të ketë 12 fëmijë më të vegjël se 1 vjeç, grupi i dytë duhet të ketë 24 fëmijë nga 1 - 2 vjeç dhe grupi i tretë përsëri 24 fëmijë nga 2 -3 vjeç.

- Nëse kapaciteti i çerdhes është 75 vende: grupi i parë duhet të ketë 15 fëmijë më të vegjël se 1 vjeç, grupi i dytë duhet të ketë 30 fëmijë nga 1 - 2 vjeç dhe grupi i tretë përsëri 30 fëmijë nga 2 -3 vjeç.

- Nëse kapaciteti i çerdhes është mbi 75 vende, drejtuesi formon grupet sipas grup moshës së fëmijëve duke pasur parasysh nënndarjet si më sipër *(ky variant i fundit nuk është i këshillueshëm, por mund të përdoret në raste të veçanta).*

4. KARAKTERISTIKAT TIPOLOGJIKE DHE DIMENSIONALE

4.1 Dimensionet e rekomanduara të çerdheve

Eksperienca europiane këshillon katër modele tipologjike, të cilat përcaktohen nga kapaciteti i çerdhes që mund të jetë 30; 45; 60 dhe 75 fëmijë.
Mjediset dhe hapësirat që do të përcaktohen më poshtë bazuar në standarde duhet të organizohen (nëse kjo është e mundur) në një kat mbi tokë. Megjithatë mund të propozohen dhe zgjidhje të ndryshme si me dy kate ku të dy katet janë mbi tokë ose një kat mund të propozohet edhe gjysmë i futur nën tokë. Në rastin e dytë (për katin gjysmë nëntokë) hapësirat që do t'iu dedikohen fëmijëve duhet të jenë patjetër në katin mbi tokë.

Sipërfaqet minimale relative për 4(katër) modelet, **Sipërfaqe Bruto e Dyshemesë (SBD):**

- për çerdhe me 30 vende SBD = 345 m²
- për çerdhe me 45 vende SBD = 465 m²
- për çerdhe me 60 vende SBD = 635 m²
- për çerdhe me 75 vende SBD = 750 m²

Lejohen variacione mbi këto SBD minimale, në plus/minus deri në 10%.
Për lartësinë e ambienteve duhet pasur parasysh që çerdhja të plotësojë standardet e projektimit të banesave sipas VKM 626 datë 15.07.2015.

4.2 Hapësirat e çerdheve

Hapësirat e brendshme dhe të jashtme të çerdheve duhet të respektojnë disa karakteristika sipas funksionit të tyre.

4.2.1 Hapësirat e brendshme në përdorim të fëmijës

Hapësirat e brendshme në përdorim të fëmijës do të nënkuptojë kompleksin e ambienteve për zhvillimin e funksioneve të mëposhtme:

- ndërrim veshjesh;
- shkëmbim informacioni të përditshëm midis prindërve dhe Kujdestareve;
- aktivitetet e lojës;
- ushqimi;
- funksionet higjienike;
- hapësirë për mobiliet dhe objektet për përdorim të përditshëm.

Hapësirat e nevojshme për funksionet e sipërpërmendura duhet të ndahen në hapësira për grupin e latantëve dhe hapësira për grupin e motakëve/të mëdhenjve.

Dimensionimi i hapësirave relative për të dy grupet duhet të bëhet me hipotezën që raporti midis numrit të latantëve dhe motakëve + të mëdhenjve duhet të jetë 1(një) me 4 (katër).
Në varësi të numrit të fëmijëve do të ketë:

- çerdhe për 30 vende: 6 latantë dhe 24 motakë +mëdhenj;
- çerdhe për 45 vende: 9 latantë dhe 36 motakë +mëdhenj;
- çerdhe për 60 vende: 12 latantë dhe 48 motakë +mëdhenj;
- çerdhe për 75 vende: 15 latantë dhe 60 motakë +mëdhenj.

- ***Hapësirat për latantët***

Duhet të parashikohen mjediset e mëposhtme dhe të respektohen hapësirat minimale të mëposhtme:

	Emërtimi i ambientit	**Sipërfaqet**	**Orientimi**
a_1	Zona e hyrjes (filtri termik)	SBD. 1.00 m²/fëmijë	veri
a_2	Zona e pranimit - dorëzimit	SBD. 0.60 m²/fëmijë	S'ka rekomandime
a_3	Dhomë loje dhe ushqimi	SBD. 3.00 m²/fëmijë	jug
a_4	Çlodhja (në ambient të ndarë)	SBD. 2.00 m²/fëmijë	jug-lindje / jug-perëndim
a_5	Shërbimet higjienike	SBD. 1.00 m²/fëmijë	lindje / veri-lindje
A	**Totali**	**SBD. 7.60 m²/fëmijë**	
a_6	Kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit (me komunikim direkt me hapësirën e ushqimit)	**SBD. 6.00 m²/fëmijë**	S'ka rekomandime

Mbi totalen $a_1/a_2/a_3/a_4/a_5$ dhe mbi hapësirën e veçantë a_6 lejohen variacione në plus/minus deri në 10%.
Hapësira e lojës dhe qëndrimit për latantët duhet të jetë ngjitur dhe komunikuese me hapësirat e lojës dhe qëndrimit të grupeve të fëmijëve në moshë më të madhe.

- *Hapësirat për motakët dhe të mëdhenjtë*

Hapësirat për këtë grup të destinuara për funksione të ndryshme, duhet të pasqyrojnë nevojën e ndarjes së fëmijëve në disa nëngrupe në raport me kapacitetin e çerdhes.
Për çerdhe me kapacitet 30 deri në 45 fëmijë kërkohet ndarja në të paktën 2 (dy) nëngrupe; për çedhet me kapacitet 60 deri në 75 fëmijë kërkohet ndarja në të paktën 3 (tre) nëngrupe.
Duhet të parashikohen Mjediset e mëposhtme dhe të respektohen hapësirat minimale të mëposhtme:

	Emërtimi i ambientit	**Sipërfaqet**	**Orientimi**
b_1	Zona e hyrjes (filtri termik) (është i mundur edhe krijimi i një ambienti të tillë të përbashkët për të gjitha grupet latantë, motakë dhe të mëdhenj)	SBD. 0.30 m²/fëmijë	veri
b_2	Një ose më shumë zona pranimi - dorëzimi (duhet të jetë e mundur lidhja e drejtëpërdrejtë me zonën e lojës dhe qëndrimit)	SBD. 0.60 m²/fëmijë	S'ka rekomandime
b_3	Dhomë loje dhe ushqimi (kërkohet një ambient i veçantë për çdo nëngrup)	SBD. 3.70 m²/fëmijë	jug
b_4	Çlodhja (kërkohet një ambient i veçantë për çdo nëngrup, të komunikojë me dhomën e lojës dhe të qëndrimit relativ)	SBD. 2.00 m²/fëmijë	jug-lindje / jug-perëndim
b_5	Shërbimet higjienike (kërkohet një ambient i veçantë për çdo nëngrup)	SBD. 1.20 m²/fëmijë	lindje / veri-lindje
b_6	Depo dhe ambiente ndihmëse	SBD. 0.20 m²/fëmijë	S'ka rekomandime
	Totali	**SBD. 8.00 m²/fëmijë**	

Mbi totalen $b_1/b_2/b_3/b_4/b_5/b_6$ lejohen variacione, në plus/minus deri në 10%.
Hapësira e lojës dhe ushqimit për çdo nëngrup duhet të jetë e tillë që të lejojë zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për çdo nëngrup në total ose aktivitete të tjera të zhvilluara njëkohësisht në grupe më të vogla prej 3 ose 5 fëmijësh dhe një të rritur. Për të bërë të mundur këtë shumëllojshmëri situatash duhet të bëhet me shumë kujdes artikullimi i hapësirave, pozicionimi i dritareve për të marrë një dritë natyrale sa më të mirë dhe të plotë, studimi i rrugëve të brendshme dhe gjithashtu vendosja e mobilieve.
Përveç kësaj kërkohet që Mjediset e lojës dhe ushqimit relative për çdo nëngrup, megjithëse, siç u përmend më lart, janë të ndarë, të kenë gjithashtu mundësi komunikimi, të paktën dy e nga dy, nëpërmjet dyerve me shumë kanata që do të lejonin në një moment krijimin e një ambienti të madh komunikues ku fëmijët mund të zgjedhin edhe aktivitetin më të pëlqyer nga ata.

Mjediset çlodhëse (gjumit) për grupin e latantëve dhe për nëngrupin e motakëve me moshë deri në 20- 24 muaj, do të përdoren disa herë gjatë ditës, dhe jo njëkohësisht nga të gjithë fëmijët; duhet atëherë që të jenë të ndara në mënyrë rigoroze nga mjediset e tjera të lojës dhe ushqimit.

Mjediset çlodhëse (gjumit) për nëngrupin e të mëdhenjve do të përdoren vetëm në orët e para të drekës; për një përdorim më të plotë të tyre duhet të projektohen, përveçse si hapësira çlodhjeje (gjumi) edhe si hapësira loje dhe si të tilla të integrueshme në hapësirën e lojës.

Në shërbimet higjienike duhet të ndahet në mënyrë të drejtë zona ku ndodhen WC-të dhe banjat me zonën ku janë vendosur lavamanët për fëmijët.
Shërbimet higjienike duhet të komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me hapësirën e lojës. Korridoret lidhëse midis kuzhinës, lavanderisë, garderobës dhe hapësirat në përdorim të fëmijëve mund të vendosen edhe brenda këtyre të fundit, vetëm duhet bërë kujdes që të mos ndërhyjnë me hapësirën çlodhëse (gjumit).

4.2.2 Hapësirat e brendshme për shërbimet e tjera

Do të kuptohen me këto të gjitha hapësirat që janë në shërbim të grupit të latantëve dhe grupit të motakëve/të mëdhenjve.
Duhet të parashikohen mjediset e mëposhtme dhe të respektohen hapësirat minimale të mëposhtme:

- kuzhinë, depo;
- lavanderi, garderobë dhe hekurosje, depo për materialet;
- dhomë zhveshjeje për kujdestaret, shërbime higjienike për të rritur;
- hapësirë polifunksionale për kujdestaret (ushqim, mbledhje, sekretari, përgatitje materialesh etj.);
- infermieri/ambulator pediatrik;
- dhomë psikologu.

Sipërfaqet minimale relative të kërkuara për këto shërbime do të jenë, **Sipërfaqe Bruto e Dyshemesë (SBD):**

- për çerdhe me kapacitet nga 30 deri në 45 fëmijë ..... min 110 m²;**SBD**
- për çerdhe me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë ..... min 160 m².**SBD**

Lejohen variacione në plus/minus deri në 10%.

Emërtimi i ambientit	Sipërfaqet	Orientimi
Zyra e drejtuesit	9m² çerdhe me kapacitet 35-45fëmijë 12m² çerdhe me kapacitet 60-75fëmijë	lindja / jug-lindja
Sekretaria (per cerdhe me mbi 75 fëmijë)	6m² çerdhe me kapacitet me mbi 75fëmijë	s'ka rekomandime
Takim prind/edukatore	12m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 18m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	lindja / jug-lindja/ veri-lindje
Infermieria	9m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 12m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	veri / veri-lindje
Psikologu	9m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 9m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	veri / veri-lindje
Zona e zhveshjes dhe tualeti	10m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 15m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	lindja / veri-lindje

Depoja qendrore	10m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 15m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	veri
Kuzhina kryesore	24m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 30m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	veri / veri-lindje
Shërbimet higjenike (jo të personelit)	9m² çerdhe me kapacitet 35-75 fëmijë	s'ka rekomandime
Depozitim karrocash (nëse është e mundur brenda godinës)	11m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 20m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	s'ka rekomandime
Dhoma e izolimit (në rast sëmundjesh)	6m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 10m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	s'ka rekomandime
Dhoma e veçantë për dhënien e gjirit	6m² çerdhe me kapacitet 35-45 fëmijë 10m² çerdhe me kapacitet 60-75 fëmijë	s'ka rekomandime

4.2.2.1 Hapësirat e brendshme të veçanta

Do të kuptohen me këto:

- dhoma e izolimit (në rast sëmundjeje) (sip.min. 6 deri në 10m² në varësi të grup moshave)
- dhoma e veçantë për dhënien e gjirit (sip.min. 6 deri në 10m² në varësi të grup moshave)

4.2.3 Hapësirat e jashtme

Brenda hapësirës që i përket çerdhes duhet të parashikohen mjediset e mëposhtme dhe të respektohen hapësirat minimale të mëposhtme:

c_1	Hapësirat e shtruara të trotuareve dhe të mbuluara për mbrojten e ambienteve në përdorim të fëmijëve (a_1, b_1) dhe shërbime të tjera (hyrje të mallrave)	**SBD 1.00 m²/fëmijë**
c_2	Hapësirat e shtruara dhe të mbuluara, të drejtuara në mënyrë të tillë që të mbrohen nga erërat, për përdorim të hapësirave të lojës në Mjediset e jashtme si zgjatim i ambienteve të brendshme në përdorim të fëmijëve	
c_3	Hapësirat e shtruara të trotuareve (jo të mbuluara) për aktivitete dhe ecje në ambiente të jashtme	**SBD 3.50 m²/fëmijë**

c_4	vaskë për rërën	
c_5	hapësira të gjelbra hapësirat e shtruara të trotuareve për akses këmbësorësh dhe	**SBD 0.50 m²/fëmijë**

c_6	mjetesh (për furnizim kuzhine, centralin termik)	

Terreni i hapësirës së lojës në pjesën e brendshme dhe të jashtme duhet të jetë, perveçse i shtruar, edhe dinamik me disnivele dhe arredime si p.sh. pergola etj.

Për arsye sigurie duhet të ndalohet që fëmijët të lëvizin dhe të komunikojnë lirshëm me Mjediset publike ose private që nuk janë pjesë e çerdhes. Kufijtë e hapësirave të lojës në ambient të jashtëm duhet të formohen me mure të vegjël jo më shumë se 20 cm dhe me bimë dekorative (mundësisht të jenë të gjelbra gjithë vitin si ligustër ose të ngjashme).

Rrethimi i terrenit ku do të projektohet çerdhja duhet të realizohet me rrjetë metalike të kryqëzuar me elemente vertikale mbajtëse me hekur (lartësia mesatare e këshilluar të jetë 1.5 m).

4.3 Raportet e rekomanduara

Raportete rekomanduara personel-fëmijë brenda dimensioneve të grupit

Përmasat e grupit / Mosha e fëmijëve	6	8	10	12	14	16	18	20
Bebe (3 muaj)	1:3	1:4						
Motakët (12-24 muaj)	1:3	1:4	1:4	1:4				
2 vjeç (24-30 muaj)		1:4	1:5	1:6				
2.5 vjeç (30-36 muaj)			1:5	1:6	1:7			
3 vjeç					1:7	1:8	1:9	1:10

* Dimensionet e grupeve më të vogla dhe raportet më të ulëta personel-fëmijë janë parë se janë parashikues të fortë të përputhjes me treguesit e cilësisë.

5. SI TË ORGANIZOHET HAPËSIRA E ÇERDHES

Çerdhet përbëhen nga pesë zona funksionale kryesore:
- Zona administrative;
- Zona e dhomave;
- Holli kryesor ose korridori kryesor;
- Shërbimet higjienike (*ku nuk përfshihen ato për personelin dhe për fëmijët*);
- Zona e jashtme.

Të gjitha këto duhen kombinuar në mënyrë të tillë që të përmbushin të gjitha standardet e kërkuara.

Organigrama



Çerdhe 1(një) katëshe



Çerdhe 2(dy) katëshe, kati i parë



Çerdhe 2(dy) katëshe, kati i dytë

5.1 Zona Administrative

Zona administrative përbëhet nga këto ambiente (*të gjitha sip. e dhëna tregojnë një limit minimal të llogaritur mbi një numër minimal të fëmijëve në çerdhe*):

- Zyra e drejtuesit (*sip. min. 12m²);*
- Hapësira e punës së asistentit/sekretarit *(sip.min. 6m² - vetëm për çerdhe me mbi 75 fëmijë*);
- Hapësira për takimet prind/kujdestare (*sip.min. 12m²);*
- Zyra e infermierisë (*sip.min. 9m²);*
- Zyra e psikologut (*sip.min. 9m²);*
- Salla dhe hapësira e punës së personelit (*sip.min.10m²*);
- Kuzhina kryesore (*sip.min. 24m²);*
- Tualetet dhe dhomat e zhveshjes së personelit (*sip.min.10m²*);
- Depo lavanderi (*sip.min.10m²*);
- Depoja qendrore e materialeve (*sip.min.10m²*).
- Depozitim karrocash (*sip.min.11m²*).

Orientimi i disa prej këtyre hapësirave këshillohet që të mos jetë nga veriu. Gjithsesi ky orientim varet nga pozita gjeografike e vendit ku do të ngrihet ndërtesa. Në disa raste, vendosja e zonës administrative me orientim nga veriu ndihmon në krijimin e kushteve më të mira për dhomat e fëmijëve (primare është çështja e orientimit nga jugu i dhomave të fëmijëve). Disa nga këto hapësira mund të orientohen nga veriu, si p.sh. depot/magazinat ose tualetet e personelit.

Më poshtë merren në shqyrtim të gjitha hapësirat e përmendura më lart.

- **Zyra e drejtuesit** ***(sip.min. 12m²)***

(dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

Përmbajtje:

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Zyrës së drejtuesit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Zyrës së Drejtuesit, hapësirat minimale të përdorimit. Në rastin kur kapaciteti i çerdhes i kalon 75fëmijë atëherë shtohet edhe mjedisi i sekretariatit. Kjo pjesë paraqet detyrimet edhe për këtë hapësirë.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zyra e drejtuesit:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillon aktivitetin administrativ dhe pritës drejtori i çerdhes.

Hapësira e punës:
Një pjesë e hapësirës së zyrës ku zhvillohet aktiviteti administrativ. Duhet të ketë minimalisht një kolltuk, dy karrige, një tavolinë, një dollap, një kompiuter dhe një printer.

Hapësira e pritjes:
Një pjesë e hapësirës së zyrës së ku zhvillohet aktiviteti i pritjes së prindërve, përfaqësuesve të administratës vendore ose qendrore.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në zyrë.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i Zyrës së Drejtuesit
Zyra e drejtuesit minimalisht duhet të përmbajë dy hapësira:
- Hapësirën e punës
- Hpapësirën e pritjes

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zyrës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Zyrën e drejtuesit është:
- 9m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë
- 12m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë

Gjerësia minimale për Zyrën e drejtuesit është:
- Gjerësia minimale 2.8 metra.

Dimensionet e Zyrës:
Gjerësia e dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2.

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zyrës së Drejtuesit.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zyrës së drejtuesit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zyrës së drejtuesit)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Zyra e drejtuesit duhet të ketë minimumi 2 orë në ditë, dritë natyrale të drejtëpërdrejtë dhe rekomandohet orientimi nga lindja ose jug lindja.

Ndriçimi natyral
Në zyrën e drejtuesit koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zyra e drejtuesit duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zyra e drejtuesit duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative

Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në Zyrën e drejtuesit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.6x1.2 h = 0.8m)
- 1 Tavolinë (Ø 0.8 h = 0.4m)
- 6 Karrige
- 1 Kolltuk
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)
- 1 Kompjuter
- 1 Printer

8. Rekomandime
Kjo zyrë duhet të projektohet e tillë që, përveç hapësirës së nevojshme të akomodimit të drejtuesit, të parashikojë edhe pritjen e prindërve. Është e këshillueshme që funksioni i dytë (pritja e prindërve) të zhvillohet në një ambient të qetë dhe komod. Kjo do të lejonte një bashkëbisedim të qetë dhe sqarues për të dyja palët.
Kjo zyrë duhet të jetë në një pozicion lehtësisht të arritshëm nga vizitorë të tjerë, mundësisht pranë recepsionit.
Në raste të çerdheve të mëdha është i nevojshëm edhe projektimi i një hapësire (paradhome) për sekretarinë e drejtuesit.
Në zyrën e drejtuesit të parashikohen të gjitha instalimet e nevojshme elektrike dhe elektronike në mënyrë që të zhvillohen sa më efektivisht të gjitha aktivitetet administrative, informative dhe komunikuese.
Të njëjtat lidhje duhen të parashikohen edhe në rastin e projektimit të një hapësire për sekretarinë.

• Sekretaria *(sip.min. 6m²)*

Sekretaria është një mjedis (paradhomë e zyrës së drejtorit). Shtohet në rastin kur çerdhja e kalon kapacitetin 75 fëmijë.

1. Zonimi i Sekretariatit

Sekretaria minimalisht duhet të përmbajë dy hapësira:
- Hapësirën e punës
- Hapësira e pritjes

2. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i sekretarisë varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që do të kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Sekretariatin është:
- 6m²

Gjerësia minimale për Zyrën është:

- Gjerësia minimale 2 metra

Dimensionet e Zyrës:
Gjerësia e dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

3. Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të sekretariatit.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Sekretariatit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Sekretariatit)

4. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Mund të projektohet si hapësirë pa dritare. Orientimi nuk ka asnjë ndikim për këtë hapësirë.

Ndriçimi natyral
Sekretaria nuk e ka të nevojshme ndriçimin natyral. Sekretaria mund të projektohet pa dritare dhe pa dritë natyrale të drejtëpërdrejtë.

Ajrimi dhe kërkesat higjienike

Sekretariati duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim të forcuar dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësië së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Sekretariati duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

5. Mobilimi minimal
Sekretariati duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.5x1.2 h = 0.8m)
- 2 Karrige
- 1 Kolltuk
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)
- 1 Kompjuter
- 1 Printer

- **Hapësira për takimet prind/kujdestare *(sip.min. 12m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

Përmbajtje:

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për takimet prind/kujdestare
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të dhomës për takimet prind/kujdestare, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Salla për takimet prind/kujdestare:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen takimet javore konsultative prind/kujdestare.

Hapësira e pritjes:
Një pjesë e hapësirës së zyrës së ku zhvillohet aktiviteti i pritjes së prindërve, përfaqësuesve të administratës vendore ose qendrore.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ/konsultativ.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për takimet prind/kujdestare
Salla përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Hapësira e pritjes

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i sallës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Sallën është:
- 12 m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë;
- 18 m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë.
-

Gjerësia minimale për Sallën është:
- Gjerësia minimale 3 metra.

Dimensionet e Sallës:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
$D > L/2$

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të sallës takim prindër/kujdestare.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të sallës takim prindër/kujdestare
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Sallës)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Salla për takim prindër/kujdestare duhet të ketë minimumi 2 orë në ditë dritë natyrale të drejtëpërdrejtë dhe rekomandohet orientimi nga lindja, jug-lindja ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral
Në Sallën e takim prindër/kujdestare koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Salla për takim prindër/kujdestare duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Salla për takim prindër/kujdestarre duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në sallën për takim prindër/kujdestare duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (Ø 0.8 h = 0.4m)
- 4 Karrige
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)

- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.6m)
- 1 Kompjuter
- 1 Printer
- 1 Projektor

8. Rekomandime

Kjo hapësirë duhet të pozicionohet në afërsi të zyrës së drejtuesit dhe mundësisht komunikuese me të, nëpërmjet një korridori lidhës. Mundësisht të pozicionohet në afërsi të hyrjes kryesore. Të jetë një zonë e qetë dhe mikpritëse në mënyrë që të krijojë besim tek prindërit. Kjo gjë duhet arritur duke përdorur në rifiniturë ngjyra të ngrohta dhe materiale natyrore si dru, gurë etj.

Ndriçimi artificial të jetë i ngrohtë, jo i bardhë. Ndriçimi natyror të jetë i përpunuar me filtra që në brendësi të vijë një dritë e ngrohtë.

Mjedisi duhet të jetë i pajisur më një librari, e cila të mbajë informacione të ndryshme për aktivitetet e çerdhes dhe se si zhvillohen ato.

Ideja kryesore është që të krijohet një mjedis i rehatshëm krahasuar me Mjediset shtëpiake.

Në çerdhet e mëdha mund të mendohen dy ambiente të tilla.

Në hapësirat për takimet prind/kujdestare të parashikohen të gjitha lidhjet e nevojshme elektrike dhe elektronike për të zhvilluar sa më shpejt të gjitha aktivitetet informative dhe komunikuese. Është e këshillueshme që në këto hapësira të ketë edhe një projektor për prezantime të ndryshme.

Kjo sallë mund të paraqitet edhe si një sallë multifunksionale, ku përveç takimeve me prindër të zhvillohen edhe aktivitete të tjera si psh: mbledhje të ndryshme të stafit, trajnime etj.

- **Infermieria *(sip.min. 9m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

Përmbajtje:

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për Infermierinë
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të dhomës për Infermierinë, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Salla për Infermierinë:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen takimet javore konsultative infermierë dhe fëmijë.

Hapësira e Vizitave:
Një pjesë e hapësirës së dhomës ku zhvillohet aktiviteti i pritjes së fëmijëve, dhe prindërve.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ/konsultativ.

Tavolinë pune:
Mobilie që përdoret për kryerjen e aktivitetit mendor.

Frigorifer:
Një pajisje në të cilën ilaçet ruhen në temperaturë të ftohtë.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në zyrë.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për Inferimierinë
Salla përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Hapësira e vizitave

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i Sallës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Sallën është:
- 9m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë;
- 12m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë.

Gjerësia minimale për Sallën është:

- Gjerësia minimale 3 metra

Dimensionet e Sallës për Infermierinë:

Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të sallës së psikologut dhe infermierisë.



Fig. 14. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Sallës së Infermierisë
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Sallës)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi

Salla për infermierinë duhet të ketë minimumi 0.5 orë në ditë, dritë natyrale të drejtëpërdrejtë dhe rekomandohet orientimi nga veriu ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në sallën për infermierinë koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Salla për infermierinë duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Salla e infermierisë duhet të ruajë këto parametra komoditeti:

Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në sallën e infermierisë duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.6x1.2 h = 0.8m)
- 1 Karrige
- 1 Kolltuk
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.4m)
- 1 Lavaman
- 1 Kompjuter
- 1 Printer
- 1 Frigorifer
- 1 Aparat disinfektimi
- 1 Krevat per vizita

8. Rekomandime

Kjo hapësirë do të përdoret 2 (dy) ditë në javë për kontrollet rutinë të fëmijëve, për kontrollin e higjienës ose për konsulta me prindërit. Madhësia e kësaj hapësire nuk duhet të jetë më e vogël se 9 (nëntë) m². Duhet të jetë e pajisur me frigorifer, dollape për depozitim farmaceutik, shtrat për vizitat, aparat dezinfektimi dhe mjete të tjera për vizita mjekësore.
Këshillohet që të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë me zyrën e drejtuesit dhe me korridorin ose hollin. Meqënëse përdorimi i kësaj hapësire është minimal rekomandohet që të pozicionohet në veri.

- **Psikologu *(sip.min. 9m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

Përmbajtje:

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për Psikologun
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të dhomës për Psikologun, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Salla për Psikologun:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen takimet javore konsultative psikolog dhe fëmijë.

Hapësira e Vizitave:
Një pjesë e hapësirës së dhomës ku zhvillohet aktiviteti i pritjes së fëmijëve, dhe prindërve.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ/konsultativ.

Tavolinë pune:
Mobilie që përdoret për kryerjen e aktivitetit mendor.

Frigorifer:
Një pajisje në të cilën ilaçet ruhen në temperaturë të ftohtë.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në zyrë.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për psikologun
Salla përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Hapësira e vizitave

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i Sallës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Sallën është:
- 9m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë;
- 9m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë.

Gjerësia minimale për Sallën është:

- Gjerësia minimale 3 metra

Dimensionet e Sallës për Psikologun:

Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të sallës së psikologut dhe infermierisë.



Fig. 14. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Sallës së Psikologut
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Sallës)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi

Salla për psikologun duhet të ketë minimumi 0.5 orë në ditë, dritë natyrale të drejtëpërdrejtë dhe rekomandohet orientimi nga veriu ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në sallën për psikologun koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Salla për psikologun duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Salla e psikologut duhet të ruajë këto parametra komoditeti:

Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në sallën e psikologut duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.6x1.2 h = 0.8m)
- 1 Karrige
- 1 Kolltuk
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.4m)
- 1 Lavaman
- 1 Kompjuter
- 1 Printer
- 1 Frigorifer
- 1 Aparat disinfektimi
- 1 Krevat per vizita

8. Rekomandime

Kjo hapësirë do të përdoret 2 (dy) ditë në javë për kontrollet rutinë të fëmijëve ose për konsulta me prindërit. Madhësia e kësaj hapësire nuk duhet të jetë më e vogël se 9 (nëntë) m². Duhet të jetë e pajisur me frigorifer, dollape për depozitim farmaceutik, shtrat për vizitat, aparat dezinfektimi dhe mjete të tjera për vizita mjekësore.
Këshillohet që të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë me sallën e infermierisë dhe me korridorin ose hollin. Meqënëse përdorimi i kësaj hapësire është minimal rekomandohet që të pozicionohet në veri.

Salla dhe hapësira e punës së personelit

(dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

Kjo hapësirë do të përmbushë disa funksione për stafin dhe do të ketë disa hapësira si psh:

- Zonën e zhveshjes / Zonën e tualeteve të stafit
- Zonën e depos së materialeve për pastrim/të ndryshme, lavanderia.

- **Zona e Zhveshjes dhe Tualeti *(sip.min. 10m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për zonën zhveshjes dhe tualeti
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të zonës së zhveshjes dhe tualetit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e zhveshjes dhe tualeti:
Hapësira e një çerdheje ku pjesëtarët e stafit të kenë mundësi të ndërrohen, të pastrohen dhe të zhvillojnë nevojat e tyre personale.

Pllakë dushi:
Pajisje për larje të plotë të trupit, duke qëndruar kryesisht në këmbë.

Lavamani:
Pajisje e furnizuar me ujë që shërben për larje të përgjithshme.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ/konsultativ.
Në rastin përkatës një pajisje në të cilën ruhen sendet presonale në mjedis të thatë e të freskët.

Aspirator:
Pajisje elektrike që kryen funksionin e thithjes mekanike ose motorike të gazrave e avujve në Mjediset e zonës së zhveshjes dhe tualetit.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për zonën e zhveshjes dhe tualeti
Salla përbëhet nga dy hapësira funksionale:
- Hapësira e larjes
- Hapësira e ndërrimit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i Zonës së zhveshjes dhe tualetit varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për zonës është:
- 10m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë;
- 15m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë.

Gjerësia minimale për Zonën është:
- Gjerësia minimale 3 metra

Dimensionet e Sallës për Zonën:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zonës së zhveshjes dhe tualeti.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zonës së Zhveshjes dhe Tualeti
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së Zhveshjes dhe Tualeti)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Për zonën e zhveshjes dhe tualetit rekomandohet orientimi nga lindja ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në zonën e zhveshjes dhe tualetit mund të ketë dy zgjidhje për ndriçimin, natyral ose artificial. Nëse ka mundësi të jetë natyral atëherë koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/10.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Zona e zhveshjes dhe tualetit duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit. Hapësira duhet të jetë e pajisur me aspirator mbi pllakat e dushit dhe mbi nyjet higjieno sanitare. Aspirmi duhet të garantojë një fluks të nxjerries jashtë të gazrave dhe avujve prej 0.5 të volumit të hapësirës në orë.
Aspiratori duhet të ketë një nivel decibel jo më shumë se 55dB dhe duhet të jetë vendosur të paktën 5cm nga tavani i zonës.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Zona e zhveshjes dhe tualetit duhet të ruajë të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7.Mobilimi minimal

Në zonën e zhveshjes dhe tualetit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 2 Pllaka dushi (0.8x0.8 m)
- 2 WC
- 1 Lavaman
- 1 Dollap për rrobat dhe depo (0.4x2 h= 2.2m)
- 1 Stol (0.4x1.4 h= 0.45m)

8. Rekomandime

Dhoma e zhveshjes do të ideohet bashkë me tualetet dhe të ketë akses me zonën e relaksit. Do të ketë dy tualete normale. Do të ketë dollape me çelës personal dhe stola. Ndriçimi për zonën e zhveshjes nuk duhet që të jetë patjetër natyror.

- **Depoja qendrore *(sip.min. 10m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës për depon qendrore
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore Depo qendrore, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Depo qendrore:
Hapësira e një çerdheje ku vendoset materiali mbështetës në shërbim të funksionimit racional të çerdhes.

Dollap:
Në rastin përkatës një pajisje në të cilën ruhen sendet në shërbim të çerdhes në mjedis të thatë e të freskët.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për Depon qendrore
Salla përbëhet nga një hapësira funksionale:
- Hapësira e depozitimit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i Depos qendrore varet nga kapaciteti i çerdhes, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Depon është:
- 10m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë;
- 15m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë.

Gjerësia minimale për Zonën është:
- Gjerësia minimale 3 metra

Dimensionet e Sallës për Zonën:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
$D > L/2$.

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Depos qendrore.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Depos qendrore
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Depos qendrore)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Për depon qendrore rekomandohet orientimi nga veriu ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral
Në Depon qendrore nuk duhet të ketë ndriçim natyral.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Depoja qendrore duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Depoja qendrore duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Depoja qendrore duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- Dollape me modul (0.4x0.4 h= 2.2m) min.20 copë
- 1/10 Dollap me çelës (0.4x0.4 h= 2.2m)

8. Rekomandime

Kjo hapësirë do të shërbejë për mbajtjen e disa materialeve, si psh: materiale kancelarie për kujdestaret dhe për fëmijët; mjetet pastruese për çerdhen, për mobiliet e ndryshme dhe lodrat e fëmijëve; materiale për mirërmbajtjen e çerdhes për elementet elektrike, hidraulike dhe impiantistike në përgjithësi.

Kjo depo duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që të jetë e aksesueshme nga jashtë dhe nga brenda. Nuk duhet të pozicionohet në pjesën qendrore ose afër hyrjes kryesore të çerdhes. Këshillohet të vendoset në afërsi të sallës së personelit dhe shërbimeve higjienike që do të jenë në shërbim të vizitorëve (prindër, persona të tjerë që bashkëpunojnë me çerdhen por nuk punojnë në të etj.).

Këshillohet të pozicionohet nga veriu përgjatë korridorit ose hollit kryesor.

- **Kuzhina kryesore** ***(sip.min. 24m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për Kuzhinën kryesore
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore kuzhinë kryesore, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Kuzhinë kryesore:
Hapësira e një çerdheje ku përgatiten vaktet kryesore.

Dollap:
Në rastin përkatës një pajisje në të cilën ruhen sendet në shërbim të çerdhes në mjedis të thatë e të freskët.

Aspirator:
Pajisje elektrike, ose jo, që kryen funksionin e thithjes, mekanike ose motorike, të gazrave e avujve që vijnë si rezultat i gatimit me ngrohtësi në mjediset e kuzhinës.

Tubi i shkarkimit:
Tubi që trasporton ajrin, gazrat e avujt nga mjediset e brendshme të çerdhes (kryesisht kuzhinë dhe tualete) mbi sipërfaqen e mbulesës së ndërtesës.

Syprinë:
Është sipërfaqja e punës për përgatitjen e ushqimit në kuzhinë.

Makinë larëse enë kuzhine (lavastovilje):
Një pajisje elektrike që përdoret për larjen e enëve në të.

Sobë gatimi:
Një pajisje e cila përdor elektricitetin ose gazin, për të prodhuar nxehtësi, për të gatuar apo ngrohur ushqim.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për kuzhinën kryesore
Kuzhina kryesore përbëhet nga dy hapësira funksionale:
- Hapësira e gatimit
- Hapësira e dhomës frigoriferike

4. Hapësira dhe dimensionimi

Dimensionimi i kuzhinës kryesore varet nga kapaciteti i çerdhes, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për kuzhinën është:

- 24m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë
- 30m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë

Gjerësia minimale për kuzhinën është:

- Gjerësia minimale 3 metra

Dimensionet e kuzhinës:

Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Kuzhinës kryesore.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Kuzhinës kryesore

(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Kuzhinës kryesore)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi

Për kuzhinën kryesore rekomandohet orientimi nga veriu ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në Kuzhinë duhet të ketë ndriçim natyral. Ndriçimi nuk duhet të jetë detyrimisht i drejtëpërdrejtë.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Kuzhina kryesore duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të dhe të realizohet në mënyrë të tillë që largimi i substancave ndotëse dhe avujve, të prodhuara nga personat ose nga proceset e zhvilluara, të realizohet në mënyrë të përshtatshme, që të sigurojë mirëqenien dhe shëndetin e personave. Hapësira e gatimit duhet të jetë e pajisur me aspirator mbi sobën e gatimit. Aspirmi duhet të garantojë një fluks të nxjerrjes jashtë të gazrave dhe avujve prej 0.5 të volumit të hapësirës në orë.
Aspiratori duhet të ketë një nivel decibel jo më shumë se 55dB dhe duhet të jetë vendosur të paktën 65cm, në lartësi, nga sipërfaqja e gatimit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Vëmendje i duhet kushtuar ngorhjes së hapësirës së kuzhinës për komoditetin e përdoruesve.

7. Mobilimi minimal
Kuzhina kryesore duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Njësi gatimi (2.2x1.4 m)
- 1 Frigorifer (0.6x0.6 m)
- 1 Lavastovilje (0.6x0.6 m)
- 1 Lavaman
- 1 Syprinë me dollape në lartësi
- 1 Aspirator
- 1 Dollap (0.4x1.6 h= 2.2m)
- 1 Dhomë frigorifer (2x2)
- Vend për shpërndarjen e ushqimit

8. Rekomandime
Të jetë lehtësisht e komunikueshme me zonat e dhomave, por edhe të ndahet nga ato me një strukturë tjetër funksionale si p.sh. korridor.
Hyrja për në kuzhinë të ketë një zgjidhje me dopio derë të tipit tambur, për të mos lejuar kalimin e aromave të ndryshme në Mjediset e tjera.
Të jetë një njësi më vete në kuadrin e mbrojtjes kundër zjarrit dhe muret, dyert dhe dritaret që e ndajnë atë të kenë një REI jo më të vogël se 60 min.
Të jetë e komunikueshme nga jashtë dhe nga brenda. Të jetë sa më afër zonës së parkimt (nëse mendohet që të ketë parkim të brendshëm) ose lehtësisht e arritshme prej njërës nga rrugët që shërbejnë çerdhen.
Të pozicionohet në katin përdhes dhe në asnjë mënyrë në kate të tjera.
Kuzhina kryesore të pozicionohet jo në kontakt me zonën e lojës në pjesën e jashtme.
Kuzhina do të projektohet si një ambient i vetëm, i cili nëpërmjet mobilimit të organizojë edhe ndarjen e funksioneve, d.m.th. të zonës së gatimit nga zona e depozitimit frigoriferik dhe zona e shpërndarjes së ushqimit.

- **Shërbimet higjienike *(sip.min. 9m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i Hapësirës për shërbimin higjienik
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të shërbimeve higjienike, hapësirat minimale të përdorimit.

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe përkufizimet

Shërbimeve higjienike:
Nyje higjieno sanitare ku detyrimisht është instaluar një WC dhe një lavaman.

Lavamani:
Pajisje e furnizuar me ujë që shërben për larje të përgjithshme.

Aspirator:
Pajisje elektrike që kryen funksionin e thithjes mekanike ose motorike të gazrave e avujve në Mjediset e shërbimeve higjienike.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës për shërbimet higjienike:
Shërbimet higjienike përbëhet nga dy hapësira funksionale:
- Hapësira e WC
- Hapësira e lavamanëve

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i shërbimeve higjienike varet nga numri i personave që do t'i përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për shërbimet higjienike është:
- 9m².

Gjerësia minimale për shërbimet higjienike është:
- Gjerësia minimale 2.5 metra

Dimensionet e shërbimeve higjienike:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
$D > L/3$

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të shërbimeve higjienike.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të shërbimeve higjienike
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së shërbimeve higjienike)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Shërbimet higjienike janë një hapësirë që vendoset në qendër të çerdhes. Nuk është i nevojshëm ndonjë specifikim për orientimin e tyre. Nëse vendosja nuk bëhet në qendër të çerdhes atëherë orientimi duhet të jetë nga veriu

Ndriçimi natyral
Shërbimet higjienike mund të kenë dy zgjidhje për ndriçimin, natyral ose artificial. Nëse ka mundësi që të jetë natyral atëherë koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/10.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Shërbimet higjienike duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të kenë ajrim natyral dhe të plotësojnë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit. Hapësira duhet të jetë e pajisur me aspirator mbi nyjet higjieno sanitare. Aspirmi duhet të garantojë një fluks të nxjerrjes jashtë të gazrave dhe avujve prej 0.5 të volumit të hapësirës në orë.
Aspiratori duhet të ketë një nivel decibel jo më shumë se 55dB dhe duhet të jetë vendosur të paktën 5cm nga tavani i zonës. Duhet të sigurohet furnizimi me ujë të rrjedhshëm dhe me cilësi.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Shërbimet higjienike duhet të ruajnë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në zonën e zhveshjes dhe tualeti duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 2 WC
- 2 Lavaman

8. Rekomandime

Kjo hapësirë (*nuk përfshihen këtu ato për personelin, të cilat u shpjeguan më lart*) do të jetë në shërbim të vizitorëve të ndryshëm (prindër ose familjarë të fëmijës, persona të ndryshëm që bashkëpunojnë me çerdhen etj.).
Duhet të komunikojë drejtpërdrejt me korridorin ose me hollin. Nuk është e domosdoshme që të kenë ndriçim natyral. Duhet që minimalisht të ketë një paradhomë me lavaman për të rritur dhe dy WC, një normale dhe tjetra për personat me aftësi të kufizuar (sipas VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara").
Rekomandohet që të vendoset në afërsi të kuzhinës dhe hapësirës së punës për personelin për arsye të impianteve hidroteknike.
Rekomandohet që të vendoset në pjesën fundore të korridoreve ose periferike të hollit kryesor.

- **Depozitim karrocash *(sip.min. 11m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fwmijeve)

Rekomandime

Kjo hapësirë (*nuk përfshihen këtu ato për personelin, të cilat u shpjeguan më lart*) do të jetë në shërbim të depozitimit tw karrocave
Duhet të komunikojë drejtpërdrejt me korridorin ose me hollin. Nuk është e domosdoshme që të kenë ndriçim natyral.
Rekomandohet që të vendoset në afërsi të kuzhinës dhe hapësirës së punës për personelin për arsye të impianteve hidroteknike.
Rekomandohet që të vendoset në pjesën qendrore të korridoreve ose të hollit kryesor në hyrje të çerdhes.
Kjo hapërirë mund të vendoset edhe jashtë nëse nuk ka mundësi të zgjidhet në pjesën e brendëshme të godinës.

SKEMA TË REKOMANDUARA KOMBINIMI TË MJEDISEVE TË ADMINISTRATËS



Zona administrata 1(një)



Zona administrata 2(dy)

5.2 Zona e Dhomave

Në pikën 3.2 janë shpjeguar dimensionet e këtyre hapësirave si dhe fakti që ndahen në dy grupe kryesore: atë të latantëve me një sipërfaqe minimale 7.5 m²/fëmijë dhe atë të grupit të dytë, motakët dhe të rriturit ku është përllogaritur 8 m²/fëmijë (këta të fundit mund të kenë disa nëngrupe).

Grupi i latantëve të përmbajë këto funksione kryesore :

- një ose më shumë zona pranimi/dorëzimi (duhet të jetë e mundur lidhja e drejtpërdrejtë me zonën e lojës dhe qëndrimit);
- dhomë loje dhe ushqimi;
- çlodhja (në ambient të ndarë);
- shërbimet higjienike (ku do të ketë edhe një dhomë për ndërrimin e pelenave dhe larjes nëse kjo është e nevojshme);
- depo dhe ambiente ndihmëse (kjo do të jetë pjesë përbërëse e zonës së pranimit);
- kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit (me komunikim direkt me hapësirën e ushqimit).

Në vazhdim do të shqyrtohen të gjitha këto zona funksionale dhe bashkëveprimi midis tyre.



Zona e dhomave

- **Zona e pranimit latantët** ***(sip.min. 3.6m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së pranimit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Pranimit për latantët, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e pranimit për latantët:
Hapësira e një çerdheje ku bëhet dorëzimi dhe marrja e fëmijëve nga prindërit.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale personale të fëmijëve.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së pranimit
Zona përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Hapësira e pranimit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Zonën është:
- 3.6m²

Gjerësia minimale për Zonën është:
- Gjerësia minimale 1.8 metra

Dimensionet e Zonës së pranimit për latantët:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zonës së pranimit.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zonës së pranimit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të zonës së pranimit)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Zona e pranimit është një mjedis i brendshëm i çerdhes dhe nuk ka përcaktime për orientimin e saj.

Ndriçimi natyral
Ndiçimi nuk duhet të jetë detyrimisht i drejtëpërdrejtë.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e pranimit nuk e ka të nevojshëm ajrimin as të drejtëpërdrejtë as të forcuar. Ajroset nga mjediset që e rrethojnë si dhoma e fëmijëve ose korridori.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Temperatura dhe niveli i lagështisë të jenë të njëjtë me dhomën e fëmijëve.

7. Mobilimi minimal
Zona e pranimit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- Dollape me modul (0.4x0.4 h= 0.5m) min.5 copë
- Dollape me varje me modul (0.3x0.4 h= 0.6m) min.5 copë.

8. Rekomandime
Zona e pranimit është një hapësirë pritjeje e pozicionuar në hyrje të klasës së latantëve dhe shërben si dhomë filtri midis korridorit apo hollit kryesor dhe klasës. Rekomandohet që në këtë zonë të vendosen dollapet për depozitimin e çantave, rrobave, këpucëve ose mjeteve të ndryshme por me dimensione të vogla.
Rekomandohet që kjo zonë të ndahet nga dhomat me një derë ose strukturë transparente, në mënyrë që të lejojë komunikimin vizual midis prindit dhe fëmijës.

- **Zonë loje dhe ushqimi (zona aktive)** ***(sip.min. 18m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së lojës dhe ushqimit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesa për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Zonës së lojës dhe ushqimit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e lojës dhe ushqimit:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen aktiviteti i lojës dhe të ushqyerit për latantët.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen dokumente, materiale dhe lojëra për fëmijët.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Tavolinë ngrënieje për latantët:
Një mobilie që shërben për ushqimin e latantëve (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Fig. Tavolinë për ushqimin e latantëve

Tapet sfungjeri:
Tapet modulor me bazë sfungjeri me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës. Çdo modul është me përmasa 0.4x0.4m dhe ka ngjyra të ndryshme. Përdoret si vend ku luajnë fëmijët.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së lojës dhe ushqimit
Zona e lojës dhe ushqimit përbëhet nga dy hapësira funksionale:
- Hapësira e ushqimit
- Hapësira e lojës

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për Zonën është:
- 18m²

Gjerësia minimale për Sallën është:
- Gjerësia minimale 4 metra

Dimensionet e Dhomës për latantët:
Gjerësia e Dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zonës së lojës dhe ushqimit.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zonës së lojës dhe ushqimit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të zonës së lojës dhe ushqimi)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Orientimi i zonës së lojës dhe ushqimit duhet të jetë nga juglindja ose jugu.

Ndriçimi natyral
Në zonën e lojës dhe ushqimit koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/5.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e lojës dhe ushqimit duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e lojës dhe ushqimit duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. **Mobilimi minimal**
Zona e lojës dhe ushqimit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës:

- Tavolinë ushqimi 1/1 (h = 0.70m)
- Karrige për ushqimin e latantëve (sexholino) 1/1
- 1 Dollap (0.3x2 h= 0.8m)
- Tapet sfungjeri me ngjyra për fëmijët 4m²
- 1 Karrige për kujdestaren

8. Rekomandime
Zona e lojës dhe ushqimit është një hapësirë kryesore ku zhvillohen aktivitete të ndryshme si loja, edukimi dhe ushqimi. Është ambienti kryesor i çerdhes. Me këtë ambient komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha mjediset e tjera. Këshillohet që të projektohet si një ambient i lirë pa struktura fikse, por organizimi i tij të bëhet me mobilie të lëvizshme. Rrugët lidhëse për te funksionet e tjera, si kuzhina dytësore, shërbimet higjienike dhe çlodhja, të lihen gjithmonë të lira nga mobiliet apo nga lodra të ndryshme.
Fëmijët në këtë ambient kalojnë shumicën e kohës, prandaj orientimi i kësaj hapësire këshillohet të jetë nga juglindja ose jugu.
Këshillohet që këto hapësira të kenë dalje në oborrin e jashtëm nëse ndërtesa e çerdhes është me një kat. Dalja për në oborr të bëhet gjithmonë me një zonë tambur për të ruajtur kondicionet hidrotermike në ambientin e dhomës.
Dyert për të dalë në këto ambiente duhet të jenë të izoluara shumë mirë, si nga ana termike ashtu dhe nga ana akustike. Hapja e tyre do të bëhet gjithmonë në drejtimin për jashtë.

- **Zona e gjumit latantët (fjetja)** ***(sip.min. 12m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së gjumit për latantët
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Zonës së gjumit për latantët, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e gjumit për latantët:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohet aktiviteti çlodhës për latantët.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen materiale dhe lojëra për fëmijët. me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Krevat me parapet:
Një mobilie që shërben për vendosjen e latantëve gjatë fazës së gjumit (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Fig. Krevat me parapet për latantët

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në Zonën e gjumit.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së gjumit për latanëtët
Zona e gjumit për latantët përbëhet nga një hapësirë funksionale:
- Hapësira e gjumit

4. Hapësira dhe dimensionimi

Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Zonën është:

- $12m^2$

Gjerësia minimale për Zonës është:

- Gjerësia minimale 3.3 metra

Dimensionet e Zonës së gjumit:

Gjerësia e Dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),

$D > L/3$

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zonës së gjumit për latantët.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zonës së gjumit për latantët

(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së gjumit për latantët)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi

Orientimi i zonës së gjumit të latantëve duhet të jetë nga juglindja ose jugu.

Ndriçimi natyral
Në zonën e gjumit të latantëve koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e gjumit të latantëve duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e gjumit për latantët duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Zona e gjumit të latantëve duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.:

- 1 Tavolinë (h = 0.45m)
- 1 Dollap (0.4x1.2 h= 0.8m)
- 6 Krevate me parapet (1x0.5 h= 0.9m)

8. Rekomandime
Zona e gjumit për latantët është një hapësirë që ka nevojë për një nivel të kontrolluar të nivelit akustik, ndaj për këtë arsye duhet të jetë një ambient më vete dhe me dyer dhe dritare me izolim shumë të mirë akustik. Orientimi i kësaj hapësire preferohet që të jetë juglindje ose jug. Në të dyja rastet një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar elementeve hijëzuese. Drita duhet të jetë lehtësisht e kontrollueshme. Duhet të jetë drejtpërdrejt e lidhur me dhomën e lojës dhe të ushqimit. Rekomandohet që kjo hapësirë të ketë dalje në oborrin e jashtëm nëse ndërtesa e çerdhes është me një kat.

- **Shërbimet higjienike për latantët** ***(sip.min. 6m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i shërbimeve higjienike për latantët
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të shërbimeve higjienike për latantët, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Shërbimet higjienike:
Hapësira e një çerdheje ku janë instaluar minimalisht një lavaman, një WC me përmasa për moshën deri në 3 vjeç dhe vendi i ndërrimit të pelenave për latantët.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen materiale për ndërrimin e fëmijëve.

WC për fëmijë:
Një pajisje higjieno sanitare e përshtatshme për latantët (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Fig. WC për latantët

Lavaman i thellë për larjen e fëmijës:
Pajisje e furnizuar me ujë që shërben për larjen e fëmijës. Thellësia 0.3 m (shih foton).

Fig. Lavaman i thellë për larjen e fëmijës

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i Shërbimeve higjienike për latantët
Shërbimet higjieno sanitare përbëhen nga tre hapësirë funksionale:
- Hapësira e WC-së
- Hapësira e lavamanit
- Hapësira e ndërrimit të pelenave

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për zonën është:
- 6m²

Gjerësia minimale për zonën është:
- Gjerësia minimale 1.7 metra

Dimensionet e shërbimeve higjieno sanitare:
Gjerësia e dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të shërbimeve higjieno sanitare.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Shërbimeve higjieno sanitare
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Shërbimeve higjieno sanitare)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Orientimi i Shërbimeve higjieno sanitare të latantëve duhet të jetë nga veriu, veri-perëndimi ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral
Në shërbimet higjieno sanitare të latantëve koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Shërbimet higjieno sanitare të latantëve duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të kenë ajrim natyral dhe të plotësojnë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Shërbimet higjieno sanitare për latantët duhet të ruajnë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Shërbimet higjieno sanitare të latantëve duhet të kenë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

- WC, 1/3 fëmijë (h = 0.30m)
- Lavaman për fëmijë, 1/3 fëmijë (h = 0.50m)
- 1 Lavaman për të rritur
- 1 Dollap (0.5x1.7 h= 0.8m)

- 1 Lavaman i thellë për larjen e fëmijës (thellësia 0.3m)
- 1 Dollap i sipërm (0.3x1.7 h= 0.8m)

8. Rekomandime

Shërbimet higjienike duhet të parashikohen në një ambient të veçantë. Kjo hapësirë do të organizohet në tre ambiente funksionale.

Një paradhomë për ndërrimin e pelenave për latantët, ku do të ketë një vend për ndërrimin e pelenave, një lavaman të thellë për larjen e latantëve nëse është e nevojshme, një lavaman normal për të rriturit (kujdestaret), një vend për depozitimin e mbetjeve, një dollap për vendosjen e materialeve ndihmëse. Duhet të mbahet parasysh që temperatura në këtë paradhomë të jetë 2°C më e lartë se në dhomat e tjera.

Rekomandohet që hapësira për WC-të dhe lavamanët të jenë të ndara. Për këtë arsye formohen dy hapësira të tjera funskionale. Në rastin e latantëve numri i WC-ve dhe i lavamanëve do të jetë më i reduktuar se grupet e tjera dhe do të ketë një raport 1/3, pra një lavaman për tre fëmijë.

Rekomandohet që shërbimet higjienike të kenë ajrim natyral. Orientimi i tyre rekomandohet që të bëhet në veri, veri-perëndim ose veri-lindje.

Të vishen me pllaka majolike anti rrëshqitëse në dysheme dhe në mure të paktën deri në një lartësi prej 150 cm.

Te hapësira e lavamanëve rekomandohet që të ketë edhe dollap për vendosjen e peshqirëve dhe mjeteve të tjera për mirëmbajtjen e shërbimeve higjienike. Dollapi ku do të vendosen pajisjet e mirëmbajtjes duhet të jetë me çelës.

- **Kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit *(sip.min. 7.5m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i kuzhinës - aneks
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të kuzhinës – aneks për latantët, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Kuzhinë / aneks:
Hapësira e një çerdheje ku ngrohen ushqime të ndryshme të parapërgatitura nga kuzhina qendrore.

Dollap:
Në rastin përkatës një pajisje në të cilën ruhen sendet në shërbim të çerdhes në mjedis të thatë e të freskët.

Aspirator:
Pajisje elektrike, ose jo, që kryen funksionin e thithjes, mekanike ose motorike, të gazrave e avujve që vijnë si rezultat i gatimit me ngrohtësi në mjediset e kuzhinës.

Tubi i shkarkimit:
Tubi që trasporton ajrin, gazrat e avujt nga mjediset e brendshme të çerdhes (kryesisht kuzhinë dhe tualete) mbi sipërfaqen e mbulesës së ndërtesës.

Syprinë:
Është sipërfaqja e punës për përgatitjen e ushqimit në kuzhinë.

Makinë larëse enë kuzhine (lavastovilje):
Një pajisje elektrike që përdoret për larjen e enëve në të.

Sobë gatimi:
Një pajisje e cila përdor elektricitetin ose gazin, për të prodhuar nxehtësi, për të gatuar apo ngrohur ushqimin.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i Kuzhinës / aneks
Kuzhina / aneks përbëhet nga një hapësirë funksionale:
- Hapësira e kuzhinës

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për Zonën është:
- 7.5m²

Gjerësia minimale për Zonës është:
- Gjerësia minimale 2.3 metra

Dimensionet e Zonës së gjumit:
Gjerësia e Kuzhinës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Kuzhinës - aneks.



Fig. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Kuzhinës-aneks
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Kuzhinës-aneks)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi
Orientimi i kuzhinës-aneks për latantët duhet të jetë nga veriu, veri-perëndimi ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral
Në kuzhinën-aneks të latantëve koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Kuzhina –aneks duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të

realizohet në mënyrë të tillë që largimi i substancave ndotëse dhe avujve, të prodhuara nga personat ose nga proceset e zhvilluara, të realizohen në mënyrë të përshtatshme, që të sigurojë mirëqenien dhe shëndetin e personave. Hapësira e gatimit duhet të jetë e pajisur me aspirator mbi sobën e gatimit. Aspirimi duhet të garantojë një fluks të nxierrjes jashtë të gazrave dhe avujve prej 0.5 të volumit të hapësirës në orë.
Aspiratori duhet të ketë një nivel decibel jo më shumë se 55dB dhe duhet të jetë vendosur të paktën 65cm, në lartësi, nga sipërfaqja e gatimit. Në Mjediset e kuzhinës – aneks duhet të sigurohet furnizimi me ujë.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e kuzhinës-aneks duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Zona e Kuzhinës-aneks duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.6x0.6 h = 0.8m)
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.6m)
- 1 Frigorifer
- 1 Lavapjat
- 1 Piastër elektrike me 2 vatra
- 1 Mikrovalë

8. Rekomandime
Kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit do të jetë hapësirë më vete. Do të jetë e aksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë me dhomën e lojës dhe ushqimit. Do të shërbejë për ngrohjen e ushqimeve të ndryshme të parapërgatitura nga prindërit ose nga kuzhina qendrore. Në këtë hapësirë nuk duhet të gatuhet asgjë. Pjesa e ngrohjes rekomandohet që të bëhet me mikrovalë.
Pajisjet e domosdoshme në këtë hapësirë janë: një banak dhe depo për depozitimin e materialeve ndihmëse, një lavaman, një frigorifer i vogël. Dera e kësaj hapësire duhet të jetë e mbyllur me çelës.

Grupi i dytë duhet të përmbajë këto funksione:

- një ose më shumë zona pranimi - dorëzimi (duhet të jetë e mundur lidhja e drejtpërdrejtë me zonën e lojës dhe qëndrimit);
- zonë loje dhe ushqimi (kërkohet një ambient i veçantë për çdo nëngrup);
- çlodhja (kërkohet një ambient i veçantë për çdo nëngrup, të komunikojë me zonën e lojës dhe të qëndrimit);
- shërbimet higjienike (kërkohet një mjedis i veçantë për çdo nëngrup);
- depo dhe ambiente ndihmëse
- kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit (me komunikim direkt me hapësirën e ushqimit).

Në vazhdim do të shqyrtohen të gjitha këto zona funksionale dhe bashkëveprimi midis tyre.

- **Zona e pranimit motakët / rriturit** ***(sip.min. 7.2m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së pranimit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të pranimit për motakët dhe të rriturit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe përkufizimet

Zona e pranimit për motakët dhe të rriturit:
Hapësira e një çerdheje ku bëhet dorëzimi dhe marrja e fëmijëve nga prindërit.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale personale të fëmijëve.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në zonë.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së pranimit
Salla përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Hapësira e pranimit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Zonën është:
- 7.2m²

Gjerësia minimale për Sallën është:
- Gjerësia minimale 2 metra

Dimensionet e Zonës së pranimit:
Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të zonës së pranimit.



Fig. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Zonës së pranimit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të zonës së pranimit)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Zona e pranimit është një mjedis i brendshëm i çerdhes dhe nuk ka përcaktime për orientimin e saj.

Ndriçimi natyral
Ndriçimi nuk duhet të jetë detyrimisht i drejtëpërdrejtë.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e pranimit nuk e ka të nevojshëm ajrimin as të drejtëpërdrejtë as të forcuar. Ajroset nga mjediset që e rrethojnë si dhoma e fëmijëve ose korridori.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Temperatura dhe niveli i lagështisë të jenë të njëjtë me dhomën e fëmijëve.

7. Mobilimi minimal
Zona e pranimit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.:

- Dollape me modul (0.4x0.4 h= 0.5m) min.5 copë
- Dollape me varje me modul (0.3x0.4 h= 0.6m) min.5 copë.

8. Rekomandime
Zona e pranimit është një hapësirë pritjeje e pozicionuar në hyrje të klasës së motakëve dhe të rriturve dhe shërben si dhomë filtri midis korridorit apo hollit kryesor dhe klasës. Rekomandohet që në këtë zonë të vendosen dollapet për depozitimin e çantave, rrobave, këpucëve ose mjeteve të ndryshme por me dimensione të vogla.
Rekomandohet që kjo zonë të ndahet nga dhomat me një derë ose strukturë transparente, në mënyrë që të lejojë komunikimin vizual midis prindit dhe fëmijës.

- **Zonë loje dhe ushqimi (zona aktive)** ***(sip.min. 44m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së lojës dhe ushqimit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Zonës së lojës dhe ushqimi për motakët dhe të rriturit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e lojës dhe ushqimi për motakët dhe të rriturit:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen aktiviteti i lojës dhe të ushqyerit për motakët dhe të rriturit.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen dokumente, materiale dhe lojëra për fëmijët.

Tavolinë ngrënieje për motakët dhe të rriturit:
Një mobilie që shërben për ushqimin e motakëve dhe të rriturve (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Fig. Tavolinë për ushqimin e motakëve dhe të rriturit

Tapet sfungjeri:
Tapet modulor me bazë sfungjeri. Çdo modul është me përmasa 0.4x0.4m dhe ka ngjyra të ndryshme me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës. Përdoret si vend ku rrinë të luajnë fëmijët.

Teatri:
Hapësirë e nevojshme për të zhvilluar aktivitete teatrale në dhomën e motakëve dhe të rriturve.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së lojës dhe ushqimit
Dhoma e motakëve dhe të rriturve përbëhet nga katër hapësirë funksionale:
- Hapësira e ushqimit
- Hapësira e lojës
- Hapësirë didaktike
- Hapësirë teatrale

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për Zonën është:
- $44m^2$

Gjerësia minimale për Sallën është:
- Gjerësia minimale 5 metra

Dimensionet e Dhomës për motakët dhe të rriturit:
Gjerësia e Dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
$D > L/2$

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Zonës së lojës dhe ushqimit të motakëve dhe të rriturve.



Fig. 21. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Zonës së lojës dhe ushqimi të motakëve dhe të rriturve
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së lojës dhe ushqimi të motakëve *dhe të rriturve)*

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Orientimi i zonës së lojës dhe ushqimit të motakëve dhe të rriturve duhet të jetë nga juglindja ose jugu.

Ndriçimi natyral
Në zonën e lojës dhe ushqimit të motakëve dhe të rriturve koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/5.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e lojës dhe ushqimi e motakëve dhe të rriturve duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësiës së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e lojës dhe ushqimi e motakëve dhe të rriturve duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal

Zona e lojës dhe ushqimi e motakëve dhe të rriturve duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

- Tavolinë ushqimi 1/4 (h = 0.35m)
- 2 Tavolina didaktike (1.2x0.7 h=0.35m)
- Karrige druri 2/1 (h = 0.20m)
- 3 Dollap (0.4x2 h= 0.8m)
- Tapet sfungjeri me ngjyra për fëmijët 4m²
- Karrige për kujdestaren 1/1 (h=0.45m)
- Teatri 2x0.7x2.1m

8. Rekomandime

Zona e lojës dhe ushqimi e motakëve dhe të rriturve është një hapësirë kryesore ku zhvillohen aktivitete të ndryshme si loja, edukimi dhe ushqimi. Është ambienti kryesor i çerdhes. Me këtë ambient komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha Mjediset e tjera. Rekomandohet që të projektohet si një ambient i lirë pa struktura fikse, por organizimi i tij të bëhet me mobilie të lëvizshme. Rrugët lidhëse për te funksionet e tjera, si kuzhina dytësore, shërbimet higjienike dhe çlodhja, të lihen gjithmonë të lira nga mobiliet apo nga lodra të ndryshme.

Fëmijët në këtë ambient kalojnë shumicën e kohës, prandaj orientimi i kësaj hapësire këshillohet që të jetë nga juglindja ose jugu.

Këto hapësira rekomandohet të kenë dalje në oborrin e jashtëm nëse ndërtesa e çerdhes është me një kat. Dalja për në oborr të bëhet gjithmonë me një zonë tambur për të ruajtur kondicionet hidrotermike në ambientin e dhomës.

Dyert për të dalë në këto ambiente duhet të jenë shumë mirë të izoluara si nga ana termike ashtu dhe nga ana akustike. Hapja e tyre do të bëhet gjithmonë në drejtimin për jashtë.

- **Zona e gjumit (fjetja)** ***(sip.min. 24m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i hapësirës së gjumit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Zonës së gjumit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Zona e gjumit:
Hapësira e një çerdheje ku zhvillohen aktiviteti çlodhës.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen materiale dhe lojëra për fëmijët.

Krevat me parapet:
Një mobilie që shërben për vendosjen e latantëve gjatë fazës së gjumit (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Fig. Krevat me parapet për motakët

Krevat për rriturit :
Një mobilie që shërben për vendosjen e të rriturve gjatë fazës së gjumit (shih foton), me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Dimensioni 125x65x26h.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në Zonën e gjumit.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i hapësirës së gjumit
Zona e gjumit e motakëve dhe të rriturve përbëhet nga një hapësirë funksionale:
- Hapësira e gjumit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për zonën është:
- 24m²

Gjerësia minimale për zonës është:
- Gjerësia minimale 3.3 metra

Dimensionet e zonës së gjumit:
Gjerësia e dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të zonës së gjumit.



Fig. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Zonës së gjumit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së gjumit)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Orientimi i zonës së gjumit për motakët dhe të rriturit duhet të jetë nga juglindja ose jugu.

Ndriçimi natyral
Në Zonën e gjumit të motakëve dhe të rriturive koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e gjumit të motakëve dhe të rriturive duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e gjumit për motakët dhe të rriturit duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Zona e gjumit të motakëve dhe të rriturve duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

- 1 Tavolinë (h = 0.45m)
- 1 Dollap (0.4x1.2 h= 0.8m)
- 12 Krevate me parapet për motakët (1.2x0.6 h= 0.9m),
  pa parapet për të rriturit (1.25x0.65 h= 0.26m),

8. Rekomandime
Zona e gjumit për motakët dhe të rriturit është një hapësirë që ka nevojë për një nivel të kontrolluar të nivelit akustik, ndaj për këtë arsye duhet të jetë një ambient më vete dhe me dyer dhe dritare me izolim shumë të mirë akustik. Orientimi i kësaj hapësire rekomandohet që të jetë juglindje ose jug. Në të dyja rastet një vëmendje të veçantë i duhet kushtuar elementeve hijëzuese. Drita duhet të jetë lehtësisht e kontrollueshme. Duhet të jetë drejtpërdrejt e lidhur me dhomën e lojës dhe të ushqimit. Rekomandohet që kjo hapësirë të ketë dalje në oborrin e jashtëm nëse ndërtesa e çerdhes është me një kat.

- **Shërbimet higjienike për motakët dhe të rriturit**
  (sip.min. 14.4m²)
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i shërbimeve higjienike për motakët dhe të rriturit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të shërbimeve higjienike për motakët dhe të rriturit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Shërbimet higjienike:
Hapësira e një çerdheje ku janë instaluar minimalisht një lavaman, një WC dhe vendi i ndërrimit të pelenave.

Dollap:
Në këtë rast një pajisje në të cilën ruhen materiale për ndërrimin e fëmijëve.

WC për fëmijë:
Një pajisje higjieno sanitare e përshtatshme për motakët ose të rriturit (shih foton), me përmasa për moshën deri në 3 vjeç.

Fig. WC për motakët dhe të rriturit

Lavaman i thellë për larjen e fëmijës:
Pajisje e furnizuar me ujë që shërben për larjen e fëmijës. Thellësia 0.3 m (shih foton).

Fig. Lavaman i thellë për larjen e fëmijës

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i shërbimeve higjienike për motakët dhe të rriturit
Shërbimet higjieno sanitare përbëhen nga dy hapësira funksionale:
- Hapësira e wc dhe e lavamanit
- Hapësira e ndërrimit të pelenave

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për zonën është:
- 14.4m²

Gjerësia minimale për zonës është:
- Gjerësia minimale 2.5 metra

Dimensionet e zonës së gjumit:
Gjerësia e dhomës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se 1/3 e gjatësisë (L),
D > L/3

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit
Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të zonës së shërbimi higjieno sanitar.



Fig. Planimetri tip e organizimit dhe mobilimit të Zonës së shërbimit higjieno sanitar.
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Zonës së shërbimit higjieno sanitar)

5. Orientimi dhe ndriçimi

Orientimi
Orientimi i shërbimeve higjieno sanitare të motakëve dhe të rriturve duhet të jetë nga veriu, veri-perëndimi ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral
Në zonën e shërbimit higjieno sanitar të motakëve dhe të rriturve koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
Zona e shërbimit higjieno sanitar të motakëve dhe të rriturve duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit, gjithashtu duhet të sigurohet furnizimi pa ndërprerje me ujë.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e shërbimit higjieno sanitar të motakëve dhe të rriturve duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal

Zona e shërbimit higjieno sanitar të motakëve dhe të rriturve duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

- WC, 1/1 fëmijë (h = 0.30m)
- Lavaman për fëmijë, 1/1 fëmijë (h = 0.50m), për moshën deri 3 vjeç
- 1 Lavaman për të rritur
- 1 Dollap (0.5x1.7 h= 0.8m)
- 1 Lavaman i thellë për larjen e fëmijës (thellësia 0.3m)
- 1 Dollap i sipërm (0.3x1.7 h= 0.8m)

8. Rekomandime

Shërbimet higjienike duhet të parashikohen në një ambient të veçantë. Kjo hapësirë do të organizohet në dy ambiente funksionale.
Një paradhomë për ndërrimin e pelenave për motakët, ku do të ketë një vend për ndërrimin e pelenave, një lavaman të thellë për larjen e motakëve nëse është e nevojshme, një lavaman normal për të rriturit (kujdestaret), një vend për depozitimin e mbetjeve, një dollap për vendosjen e materialeve ndihmëse. Duhet të mbahet parasysh që temperatura në këtë paradhomë të jetë 2°C më e lartë se në dhomat e tjera.
Rekomandohet që hapësira për WC-të dhe lavamanët të jenë në një hapësirë. Në rastin e motakëve dhe të rriturve numri i WC-ve dhe i lavamanëve do të ketë një raport 1/1, pra një lavaman dhe një wc për cdo fëmijë, si dhe të ketë ujë të rrjedhshëm
Shërbimet higjienike rekomandohet që të kenë ajrim natyral. Orientimi i tyre rekomandohet të bëhet në veri, veri-perëndim ose veri-lindje.
Të vishen me pllaka majolike anti rrëshqitje në dysheme dhe në mure të paktën deri në një lartësi prej 150 cm.
Te hapësira e lavamanëve rekomandohet që të ketë edhe dollap për vendosjen e peshqirëve dhe mjeteve të tjera për mirëmbajtjen e shërbimeve higjienike. Dollapi ku do të vendosen pajisjet e mirëmbajtjes duhet të jetë me çelës.

- **Kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit *(sip.min. 7.5m²)***
  (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i kuzhinës - aneks
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Kuzhinës – aneks për motakët dhe për të rriturit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Kuzhinë / aneks:
Hapësira e një çerdheje ku ngrohen nga kuzhina qendrore.

Dollap:
Në rastin përkatës një pajisje në të cilën ruhen sendet në shërbim të çerdhes në mjedis të thatë e të freskët.

Aspirator:
Pajisje elektrike, ose jo, që kryen funksionin e thithjes, mekanike ose motorike, të gazrave e avujve që vijnë si rezultat i gatimit me ngrohtësi në mjediset e kuzhinës.

Tubi i shkarkimit:
Tubi që trasporton ajrin, gazrat e avujt nga mjediset e brendshme të çerdhes (kryeisht kuzhinë dhe tualete) mbi sipërfaqen e mbulesës së ndërtesës.

Syprinë:
Është sipërfaqja e punës për përgatitjen e ushqimit në kuzhinë.

Makinë larëse enë kuzhine (lavastovilje):
Një pajisje elektrike që përdoret për larjen e enëve në të.

Sobë gatimi:
Një pajisje e cila përdor elektricitetin ose gazin, për të prodhuar nxehtësi, për të gatuar apo ngrohur ushqim.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i Kuzhinës-aneks
Shërbimet përbëhen nga një hapësirë funksionale:
- Hapësira e kuzhinës

4. Hapësira dhe dimensionimi

Dimensionimi i zonës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.

Sipërfaqja minimale për Zonën është:

- 7.5m²

Gjerësia minimale për Zonës është:

- Gjerësia minimale 2.3 metra

Dimensionet e Zonës së gjumit:

Gjerësia e Kuzhinës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Kuzhinës - aneks.



Fig. 24. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Kuzhinës-aneks

(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Kuzhinës-aneks)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi

Orientimi i Kuzhinës-aneks për motakët dhe për të rriturit duhet të jetë nga veriu, veri-perëndimi ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në Kuzhinën-aneks të motakëve dhe të rriturve koeficienti i Ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Kuzhina –aneks duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të

realizohet në mënyrë të tillë që largimi i substancave ndotëse dhe avujve, të prodhuara nga personat ose nga proceset e zhvilluara, të realizohen në mënyrë të përshtatshme, që të sigurojë mirëqenien dhe shëndetin e personave. Hapësira e gatimit duhet të jetë e pajisur me aspirator mbi sobën e gatimit. Aspirimi duhet të garantojë një fluks të nxierrjes jashtë të gazrave dhe avujve prej 0.5 të volumit të hapësirës në orë.
Aspiratori duhet të ketë një nivel decibel jo më shumë se 55dB dhe duhet të jetë vendosur të paktën 65cm, në lartësi, nga sipërfaqja e gatimit. Duhet të sigurohet furnizimi pa ndërprerje me ujë.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë
Zona e Kuzhinës-aneks duhet të ruajë këto parametra komoditeti:
Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 35% minimumi i lagështisë relative

7. Mobilimi minimal
Zona e Kuzhinës-aneks për motakët dhe për të rriturit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë:

- 1 Tavolinë (0.6x0.6 h = 0.8m)
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.6m)
- 1 Frigorifer
- 1 Lavaman
- 1 Piastër elektrike me 2 vatra
- 1 Mikrovalë

8. Rekomandime
Kuzhina - aneks për përgatitjen e ushqimit do të jetë hapësirë më vete. Do të jetë e aksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë me dhomën e lojës dhe ushqimit. Do të shërbejë për ngrohjen e ushqimeve të ndryshme të parapërgatitura nga prindërit ose nga kuzhina qendrore. Në këtë hapësirë nuk duhet të gatuhet asgjë. Pjesa e ngrohjes rekomandohet të bëhet me mikrovalë.
Pajisjet e domosdoshme në këtë hapësirë janë: një banak dhe depo për depozitimin e materialeve ndihmëse, një lavaman, një frigorifer i vogël. Dera e kësaj hapësire duhet të jetë e mbyllur me çelës.

Dhomat e veçanta

- **Dhoma e izolimit *(sip. 6m² -10m²)***

1. Fusha e veprimit
2. Termat dhe përkufizimet
3. Zonimi i dhomës së izolimit
4. Hapësira dhe dimensionimi
5. Orientimi dhe Ndriçimi
6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë
7. Mobilimi minimal
8. Rekomandime

1. Fusha e veprimit

Kjo pjesë paraqet detyrimet për projektimin e njësisë hapësinore të Dhomës së izolimit, hapësirat minimale të përdorimit.
Këto standarde nuk mbulojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë shprehur në VKM 1503, datë 19.11.2008, "Për personat me aftësi të kufizuara".

Ky standard zbatohet në çerdhet shtetërore dhe private.

2. Termat dhe Përkufizimet

Dhoma e izolimit:
Hapësira e një çerdheje ku parashikohet izolimi i fëmijëve të sëmurë, kryesisht me diarre akute, por edhe me temperaturë ose me çdo sëmundje të shfaqur.

Hapësira e Vizitave:
Një pjesë e hapësirës së dhomës ku zhvillohet aktiviteti i pritjes së fëmijëve, dhe prindërve.

Dollap:
Një pajisje në të cilën ruhen dokumente dhe materiale që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit administrativ/konsultativ.

Tavolinë pune:
Mobilie që përdoret për kryerjen e aktivitetit mendor.

Frigorifer:
Një pajisje në të cilën ilaçet ruhen në temperaturë të ftohtë.

Hapësirë mobilimi:
Hapësira e nevojshme për vendosjen e mobilies në zyrë.

Hapësirë aktiviteti:
Hapësira e nevojshme për të kryer aktivitetin që ka të bëjë me përdorimin e mobilies.

3. Zonimi i Dhomës së izolimit
Dhoma përbëhet nga një hapësirë e vetme funksionale:
- Dhoma e izolimit

4. Hapësira dhe dimensionimi
Dimensionimi i Sallës varet nga numri i personave që do ta përdorin, funksioni që kryhet, lloji dhe përmasat e mobilieve dhe kërkesat higjienike.
Sipërfaqja minimale për Sallës është:
- 6m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 35 deri në 45 fëmijë
- 10m² në rastin e çerdheve me kapacitet nga 60 deri në 75 fëmijë

Gjerësia minimale për Dhomën është:

- Gjerësia minimale 2.5 metra

Dimensionet e Sallës për Dhomën e izolimit:

Gjerësia e Sallës (D) nuk duhet të jetë më e vogël se gjysma e gjatësisë (L),
D > L/2

Hapësira e aktivitetit dhe mobilimit

Në skicën planimetrike të mëposhtme jepen përmasat minimale të hapësirës dhe të aktivitetit të mobilieve bazë të Dhomës së izolimit.



Fig. 14. Planimetri tip i organizimit dhe mobilimit të Dhomës së izolimit
(kjo planimetri jep vetëm informacion për standardet minimale të kërkuara, nuk jep informacione mbi formën planimetrike të Sallës)

5. Orientimi dhe Ndriçimi

Orientimi

Dhoma e izolimit duhet të ketë minimumi 0.5 orë në ditë, dritë natyrale të drejtëpërdrejtë dhe rekomandohet orientimi nga veriu ose veri-lindja.

Ndriçimi natyral

Në dhomën e izolimit koeficienti i ndriçimit (raporti midis sipërfaqes së dritareve, kundrejt sipërfaqes së dyshemesë) duhet të jetë jo më pak se 1/8.

6. Ajrimi dhe kërkesat për higjienë

Dhoma e izolimit duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të ketë ajrim natyral dhe të plotësojë kushtet higjienike të cilësisë së ajrit.

Ngrohja/temperatura dhe nivelet e lagështisë

Dhoma e izolimit duhet të ruajë këto parametra komoditeti:

Dimër: 21°C; 35% minimumi i lagështisë relative
Verë: 24-26°C; 50% maksimalja e lagështisë relative.

7. Mobilimi minimal
Në dhomën e izolimit duhet të ketë minimalisht këto mobilie dhe aksesorë, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

- 1 Tavolinë (0.6x1.2 h = 0.8m)
- 1 Karrige
- 1 Kolltuk
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 2.4m)
- 1 Dollap (0.3x1.6 h= 0.4m)
- 1 Lavaman
- 1 Kompjuter
- 1 Printer
- 1 Frigorifer
- 1 Aparat disinfektimi
- 1 Krevat per vizita

8. Rekomandime
Kjo hapësirë do të përdoret sa herë që të jetë e nevojshme. Madhësia e kësaj hapësire nuk duhet të jetë më e vogël se 6 (gjashtë) m². Duhet të jetë e pajisur me frigorifer, dollape për depozitim farmaceutik, shtrat për vizitat, aparat dezinfektimi dhe mjetet të tjera për vizita mjekësore, një larëse duarsh, trisol për rehidrimin paraprak të fëmijëve, antipiretikë, analgezikë. Menjëherë rekomandohet vizita mjekësore.
Këshillohet që të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë me zyrën e infermierisë dhe me korridorin ose hollin. Meqënëse përdorimi i kësaj hapësire është minimal rekomandohet që të pozicionohet në veri.

- **Dhoma e veçantë për dhënien e gjirit *(sip. 6m² -10m²)***

Dhoma e veçantë për dhënien e gjirit, parashikohet në mjediset e pranimit. Kjo mund të shërbejë dhe si dhomë pritjeje ose edukimi kur në çerdhe nuk ka fëmijë latantë.
Dhoma të pajiset me mjetet e nevojshme si stola, tavolina ku vendosen mjetet e nevojshme për pastrimin e gjoksit si ujë i zierë me acid borik 2%, pambuk ose garza, peceta, lavaman, sapun, peshqir, bluza të bardha.

5.3 Holli kryesor ose korridori kryesor *(sip. min. 10% e sipërfaqes së shërbimit)*

Kjo hapësirë shërben si element lidhës midis zonës administrative dhe dhomave të tjera. Zgjidhja arkitektonike e kësaj hapësire mund të ketë qasje të ndryshme si lineare, qendrore etj. Kjo zgjidhje varet nga pozicioni gjeografik dhe urban ku do të ndërtohet çerdhja. Holli duhet të jetë i aksesueshëm nga jashtë nga hyrja kryesore. Kjo hyrje duhet të zgjidhet me sistemin dopio derë ose tambur për të ruajtur sa më mirë kushtet termike të çerdhes. Holli ose korridori këshillohet që të ketë edhe dalje sigurie (të paktën dy). Këto dalje sigurie do të shërbejnë edhe si hyrje shërbimi për në mjediset e kuzhinës kryesore ose të depos.
Holli/korridori këshillohet që të ketë një kënd ekspozite për të paraqitur punimet e ndryshme të fëmijëve, të ketë dollape për depozitimin e materialeve të ndryshme të fëmijëve. Të ketë një gjerësi minimalisht 180 cm (kjo gjerësi vlen në rastin kur kemi të kombinuar hollin kryesor me korridor). Në rastet kur kemi prezent vetëm korridorin atëherë gjerësia minimale këshillohet të jetë 200 cm.
Holli ose korridori mund edhe të mos marrë dritë natyrale, por gjithsesi duhet të jetë i ndriçuar shumë mirë.

5.4 Zona e jashtme

Kjo hapësirë do të ketë disa funksione:

- hapësira e lojës;
- hapësira e rrugëve lidhëse dhe parkimit;
- hapësira e impiantit qendror të ajrim kondicionimit.

Duhet të zërë rreth 65% të pronës ku do të vendoset çerdhja*(35% këshillohet të jetë koeficenti i shfrytëzimit të çerdhes).*
Duhet të rrethohet me mure ndarëse minimumi 90 cm dhe maksimumi 250 cm.
Lartësia varet nga kondicionet urbane dhe gjeografike por edhe nga orientimi. Në pjesën veriore, duke menduar që ka prezencë erërash dimërore, të zgjdhet lartësia 250 cm, kurse në pjesën ku bie më shumë diell, në jug dhe jug-lindje mund të këshillohet një lartësi minimale. Në rastin në fjalë përveç murit duhet të mendohet edhe një strukturë kangjellash për ndarjen fizike të çerdhes nga ambienti urban. Duhet të parashikohet vendosja e gjelbërimit të territorit, por duke mos penguar ndriçimin.

Hapësira e lojës do të pozicionohet në pjesën jugore ose juglindore të pronës ku do të ndërtohet çerdhja në mënyrë që të jetë e ndriçuar nga dielli gjatë gjithë periudhës së përdorimit të çerdhes

nga ana e fëmijëve. Rekomandohet që 25% e zonës së lojës të jetë në hije. Kjo mund të arrihet me elemente hijëzuese si pjergollata ose elemente të ngjashme.
Duhet të lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me dhomat. Kështillohet që të jetë e pozicionuar në një vend të mbrojtur nga zhurma e mjeteve motorike dhe jo afër impiantit qendror të ajrim-kondicionimit.
Rekomandohet gjithashtu që të rrethohet me një bimësi jo të lartë deri në 20 cm lartësi (e cila duhet të jetë e gjelbër gjatë gjithë vitit si ligustra etj.). Kjo hapësirë të jetë unike për të gjitha grupet, por gjithashtu të krijohet mundësia e ndarjes së tyre me mobilim të lëvizshëm nëse e kërkojnë rrethanat (të jetë një hapësirë fleksibël).

Aksesibiliteti i kësaj hapësire të kryhet edhe nga anët e tjera të Zonës së jashtme.

Hapësira e rrugëve lidhëse dhe parkimit. Rrugët lidhëse do të ndihmojnë komunikimin e funksioneve të ndryshme si në Zonën e jashtme ashtu edhe me vetë çerdhen. Gjerësia e tyre varet nga funksioni apo funksionet që duhet të lidhë, por gjithsesi jo më të vogla se 120 cm. Zona e hyrjes për në oborrin e çerdhes, e cila do të ketë edhe lëvizshmërinë më të madhe, duhet të ketë dimensione të tilla që të lejojë zhvillimin e këtyre aktiviteteve si :

- aksesibiliteti i makinave (flitet këtu për makina personale të stafit ose për furnizimin e çerdhes me materiale të ndryshme, jo për makinat e familjarëve të fëmijëve);
- asksesibiliteti i karrocave;
- aksesibilitet i personave me aftësi të kufizuar;
- etj …

Për këtë arsye këshillohet që pjesa e hyrjes kryesore të çerdhes të trajtohet nga ana dimensionale si një shesh pritës kryesor ku gjelbërimi të vendoset vetëm në pjesët periferike të saj. Dera kryesore të projektohet me dimensione të tilla që të lejojë aksesin edhe për këmbësorët, por edhe për mjetet motorike të shërbimit. Nga ky shesh të zhvillohen të gjitha rrugët e tjera lidhëse këmbësore me gjerësi min 120 cm. Në afërsi të sheshit te hyrja kryesore dhe mundësisht shumë afër me çerdhen këshillohet që të vendoset një strehë për vendosjen e karrocave.
Materialet e sheshit dhe të rrugëve lidhëse këshillohet që të jenë lokale, të jenë modulore, lehtësisht të çmontueshme për të lejuar mirëmbajtjen e tyre të lehtë në rast dëmtimi, me sipërfaqe jo të rrëshqitshme. Këshillohen pllaka betoni vetëbllokuese.

Parkimet të mendohen vetëm për një numër të kufizuar të stafit në një raport të këshillueshëm 1/4 (një parkim në katër persona të stafit) dhe një për makinat e furnizimeve të ndryshme. Gjithsesi këshillohet një numër jo më i madh se 4 parkime.

Hapësira e impiantit qendror të ajrim kondicionimit. Kjo hapësirë të pozicionohet në pjesën veriore dhe të ruhen distancat e sigurisë.
Në rast se shihet e pamundur ruajtja e këtyre distancave, atëherë është e nevojshme, për arsye sigurie, që projektimi i këtij ndërtimi të zhvillohet në konsultë të vazhduar me specialistë të ndryshëm të fushës si zjarrfikës, inxhinierë impiantesh, arkitektë impiantesh, teknikë të ndryshëm.
Sidoqoftë materialet e ndërtimit duhet të kenë një rezistencë ndaj zjarrit min. REI 90.
Dimensionet e kësaj strukture duhet t'i përshtaten dimensioneve të impiantit të ajrim-kondicionimit (nuk mund të jepen dimensione fikse sepse edhe impiantet janë të ndryshme).

6. MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT

Ky kapitull paraqet kriteret për projektimin dhe ndërtimin e elementeve dhe sistemeve në tërë çerdhen dhe trajton rregulloret përkatëse për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë.
Vendndodhja: Çerdhet pranë oborrit duhet të kenë mjete të miratuara për daljen për në një zonë të sigurt. Çerdhja nuk duhet të ndodhet nën nivelin e daljes nga ndërtesa.
Përjashtim: Pjesë të çerdhes që ndodhen një kat mbi nivelin e daljes ku zonën e zënë vetëm fëmijë (24 muajsh apo më shumë).

6.1 Kërkesat për Mjetet e Daljes

- Vendndodhja e çerdhes duhet të lejojë daljen drejt vendeve të sigurta nëpërmjet rrugëve horizontale ose nëpërmjet panduseve me pjerrësi jo më të madhe se 8%. Nëse pandusi është shumë i gjatë këshillohet që çdo 10 m të vendosen shesh pushime.

- Në katet gjysmënëntokë nuk duhet të lejohet vendosja e aktiviteteve për fëmijë.

- Çerdhet duhet të vendosen në zona urbane lehtësisht të aksesueshme nga mjetet e zjarrfikësve.

- Ngarkesa specifike e zjarrit nuk duhet të kalojë 300 MJ/m²; janë të lejuara zona të veçanta ku ngarkesa specifike mund të shkojë ≤ 450 MJ/m².

- Dritaret nuk duhet të jenë të pajisura me skara

- Hapja e dyerve duhet të kryhet nga brenda jashtë

- Strukturat mbajtëse dhe ndarëse të çerdheve, dhe ato të kateve nëntokë, duhet të garantojnë një rezistencë ndaj zjarrit R dhe REI/EI jo më të vogël se:
  - 45 për ndërtesat me lartësi kundër zjarrit më të vogël se 12 m;
  - 60 për ndërtesat me lartësi kundër zjarrit ndërmjet 12 m dhe 32 m;
  - 90 për ndërtesat me lartësi kundër zjarrit mbi 32 m.

- Çerdhja duhet të ndahet në zona të posaçme kundër zjarrit të llogaritura, jo më të mëdha se 600 m². Këshillohet që ndarja në zona të përputhet me ndarjet funksionale. Këto zona duhet të ndahen nga njëra-tjetra me sistem pritjeje zjarri. Në mënyrë më të detajuar, duke u bazuar edhe te organigrama e një çerdheje, duhet të parashikohen këto zona të posaçme kundër zjarrit:
  - Zona administrative (duke pasur parasysh që hapësira e kuzhinës të jetë një zonë më vete e posaçme kundër zjarrit);
  - Holli ose korridori të jetë një zonë më vete;
  - Çdo dhomë të jetë një zonë e posaçme kundër zjarrit (do ketë një për çdo grup fëmijësh).
- Mjetet për hapje dyersh në rast urgjence apo daljet e urgjencës duhet të instalohen si mjete daljeje që t'u shërbejnë më shumë se 100 personave.

- Korridoret pa krye (dalje) nuk duhet t'i kalojnë 6.1 m.

- Korridoret e daljes nuk duhet të jenë më shumë se 23 m.

- Distanca e udhëtimit mes derës së një dhome, e cila është dalje urgjence dhe daljes nuk duhet të jetë më shumë se 30 metra.

- Distanca e ecjes nga çdo pikë në dhomën e gjumit dhe një dere daljeje në atë dhomë nuk duhet t'i kalojë 15 m.

- Në ndërtesat e çerdheve, aty ku është e mundur, çdo klasë dhe dhomë aktiviteti duhet të ketë një dalje direkte për në Mjediset e jashtme.

- Çdo qendër duhet të ketë të paktën dy mjete daljeje, nga ku mund të dilet nëpërmjet korridoreve të mbrojtura me ndarjet e duhura kundër zjarrit.



6.2. Reaksioni ndaj zjarrit i materialeve të ndërtimit

Përzgjedhja e materialevetë ndërtimit duhet të bazohet në normat europiane EN 13501-1për reaksionin ndaj zjarrit. Sipas këtyre normave Klasat janë:

Klasifikimi kryesor (sigla fl pas klasës tregon materialet që përdoren në dysheme)		
A1	+ + + + +	Klasë materialesh të padjegshëm (xham, lesh xhami, metale, porcelan, etj...)
A2		
B	+ + + +	Klasë materialesh të djegshëm jo të ndezshëm
C	+ + +	Klasë materialesh të djegshëm jo lehtësisht të ndezshëm
D	+ +	
E	+	

F	-	Klasë materialesh të djegshëm dhe lehtësisht të ndezshëm

Tabela 1(info marë nga D.M. 10/03/05, Italy)

Klasifikim i aksesoreve			
s	1	+ + (më e mirë)	s = tym: prodhim tymi gjatë djegjes
	2	+	
	3	- (më e ulët)	
d	0	+ + (më e mirë)	d = pikim: pikim gjatë djegjes
	1	+	
	2	- (më e ulët)	

Tabela 2 (info marë nga D.M. 10/03/05, Italy)

** prapashtesa **fl** do të thotë që vendodhja është në dysheme*
** prapashtesa **n** do të thotë që vendodhja është në tavan ose mure*

Tabelat e mëposhtme japin një informacion më të plotë :

TABELA 1 Klasat e reaksionit nga zjarri të lejuara, për çdo përqindje, në atriume (holle), korridore, shkallë, në panduse apo në pasazhe në përgjithësi					
Në dysheme	Në mure	Në tavan	Çati dhe tavane të varura	Produkte të izoluara	
				(në mur)	(në tavan)
A1n	A1	A1	A1	A1	A1

TABELA 2 Klasat e reaksionit nga zjarri të lejuara, për jo më shumë se 50% e sipërfaqes, në atriume (holle), korridore, shkallë, në panduse apo në pasazhe në përgjithësi. Materialet e tjera duhet t'i nënshtrohen Tabelës 1.					
Në dysheme	Në mure	Në tavan	Çati dhe tavane të varura	Produkte të izoluara	
				(në mur)	(në tavan)
A2n-s1, A2n-s2	A2-s1-d0, A2-s2-d0, A2-s1-d1, A2-s2-d1	A2-s1-d0, A2-s2-d0	A2-s1-d0, A2-s2-d0	A2-s1-d0, A2-s2-d0, A2-s1-d1, A2-s2-d1	A2-s1-d0, A2-s2-d0
BF1-s1,BF1-s2	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0

TABELA 3 Klasat e reaksionit nga zjarri të lejuara në zonat ku ka prezencë fëmijësh					
Në dysheme	Në mure	Në tavan	Çati dhe tavane të varura	Produkte të izoluara	
				(në mur)	(në tavan)
A1, A1n	A1	A1	A1	A1	A1
A2n-s1, A2n-s2	A2-s1-d0, A2-s2-d0, A2-s1-d1, A2-s2-d1	A2-s1-d0, A2-s2-d0	A2-s1-d0, A2-s2-d0	A2-s1-d0, A2-s2-d0, A2-s1-d1, A2-s2-d1	A2-s1-d0, A2-s2-d0

BF1-s1,BF1-s2	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0	B-s1-d0, B-s2-d0

Tendat duhet të kenë një reaksion jo më të madh se 1. Mobiliet me mbushje si kolltukët, divanët, jastëkët, dyshekët etj.) duhet të jenë të klasit 1 IM.
Është e lejuar përdorimi i veshjeve prej druri por duke pasur parasysh trajtimin e tyre me produkte të klasit 1 të reaksionit ndaj zjarrit.

6.3 Shkallët

- Të gjitha shkallët që bëjnë pjesë në rrugët e evakuimit kundër zjarrit duhet të kenë ngarkesa specifike të zjarrit që nuk duhet të kalojnë 300 MJ/m² ose 17kg/m²;; janë të lejuara zona të veçanta ku ngarkesa specifike mund të shkojë ≤ 450 MJ/m² ose 25kg/m², dhe duhet të të çojnë nëpërmjet rrugëve të mbrojtura në vende të sigurta ose jashtë godinës.
- Trupi i shkallës duhet të pajiset me çarje ajrimi, me një sipërfaqe jo më të vogël se 1 m² me sistem komandimi automatik të lidhur me sensorët kundër zjarrit. Nëse nuk ka sistem komandimi automatik atëherë mekanizmi i hapjes manuale duhet të vendoset në afërsi të hyrjes së shkallëve, në një pozicion të treguar me sinjalistikë.

6.4 Dimensionimi i rrugëve të daljeve kundër zjarrit

6.4.1.Sistemi i rrugëve të daljeve kundër zjarrit

Çdo zonë ndarjeje kundër zjarrit duhet të ketë një sistem të vetin rrugësh kundër zjarrit, që të çojnë në vende të sigurta dhe të qeta. Këto zona duhet të dimensionohen në bazë të dendësisë e grumbullimit dhe numrit maksimal të fluksit të personave dhe të realizohen sipas të dhënave të mëposhtme.

- **Dendësia e grumbullimi**

Dendësia e grumbullimi total përcaktohet si shumatore e të gjitha dendësive të zonave të ndarjes kundër zjarrit siç tregohet më poshtë:

- në dhoma: numri i personave, të rritur dhe fëmijë, të parashikuar realisht;
- holli, korridori apo ambiente të tjera me fluks njerëzish të llogariten si: 0,4 persona/m²;
- administrata, zyrat dhe Mjediset e shërbimit të llogariten: 20% e numrit të personave të parashikuar realisht.

- **Kapaciteti i fluksit të personave në dalje**

Kapaciteti i fluksit të personave në dalje nuk duhet të jetë më i madh se 50 persona për çdo kat.

- **Gjerësia e rrugëve të daljes kundër zjarrit**

- Gjerësia e daljeve për çdo kat përcaktohet si raport i Dendësisë së grumbullimit maksimal dhe Kapacitetit të fluksit të njerëzve në dalje.
- Është i lejuar përdorimi, për daljen e fluksit të njerëzve, shkallë, kalime, dhe dalje me gjerësi minimale 0.9 m i cili do të kuptohet si një modul.
- Në rastin e zhvillimit të ndërtesës në dy kate mbi tokë, gjerësia totale e rrugëve të daljes kundër zjarrit duhet të llogaritet duke mbledhur dendësinë e grumbullimit të dy kateve.

- Gjerësia e çdo daljeje emergjence duhet të jetë shumëfishi i moduli të daljes (0.6 m) dhe gjithsesi jo më pak se dy module.

6.4.2.Daljet horizontale progresive

Në përcaktimin e rrugëve të daljes kundër zjarrit janë të lejuara daljet horizontale progresive. Për të arritur këtë objektiv duhet që çdo kat të ndahet në të paktën dy zona ndarjeje kundër zjarrit të përshtashme për të mbajtur, në raste emergjence, të gjithë numrin e personave të rritur dhe fëmijëve. Zona në fjalë duhet të llogaritet me një sipërfaqe mesatare prej 0.70 m²/person.
Kjo sipërfaqe shkon në 1.50 m²/person në rastin kur lëvizja e fëmijëve bëhet me mjete ndihmëse (në dhomën e gjumit vendoset një krevat me rrota që shërben në raste zjarri për largimin e fëmijëve në mënyrë të shpejtë, sidomos për dhomat e latantëve dheraporti i krevateve të tillë llogaritet 1/4 krevate).

6.5 Zona dhe Impiante me rrezikshmëri të lartë

Karakteristika të përgjithshme

- Të gjithë impiantet duhet të projektohen dhe realizohen sipas rregullave specifike teknike në përputhje me të gjitha normativat në fuqi.
- Këto impiante duhet të garantojnë këto objektiva:
  - të mos ndryshojnë ndarjet funskionale;
  - të ndalojnë riqarkullimin e prodhimeve të gazit nga djegia ose gazrave të tjerë të rrezikshëm;
  - të mos prodhojë, si pasojë e defekteve, tymit që mund të shpërndahen në zonat funksionale;
  - të mos përbëjnë rrezikshmëri në shpërhapjen e tymit ose flakëve, edhe në fazën e parë të zjarrit.

6.5.1.Impiantet që prodhojnë nxehtësi dhe paketimi i vakteve

Impiantet për gatim me fuqi më të vogël se 35 kW duhet të vendosen në zona me strukturë mbajtëse dhe elemente ndarëse ose komunikuese me mjedise të tjera, me karakteristikë REI sipas përcaktimit të mëposhtëm:

- REI 45për ndërtesat me lartësi kundërzjarrit më të vogël se 12 m;
- REI 60 për ndërtesat me lartësi kundërzjarrit ndërmjet 12 m dhe 32 m;
- REI 90për ndërtesat me lartësi kundër zjarrit mbi 32 m;

Në çdo rast nuk është i lejuar komunikimi me ambiente të tjera përveç atyre të konsumimit të vakteve.
Në Mjediset ku impianti punon me gaz (nëse ka një të tillë) duhet të ketë një sistem rilevimi automatik i prezencës së gazit i lidhur me një elektrovalvul të jashtme për kapjen dhe përcjelljen e sinjalit dhe një sistem alarmitë përshtatshëm që të sinjalizojë prezencën e gazit.
Nuk është e lejuar prezenca e mbajtësve të gazit (bombola etj.) në zonat e brendshme të çerdhes.

6.5.2. Zonat që përcaktohen si depozita

Është e lejuar prezenca e depove me sipërfaqe të limituar (max 10 m²), për ruajtjen e materialeve që i nevojiten çerdhes, të cilat duhet të plotësojnë këto kushte:

- Struktura ndarëse dhe porta komunikuese me REI si në përcaktimin e mëparshëm;
- Hapje për ajrim baraz me 1/40 e sipërfaqes së planit të depozitës;
- Ngarkesa specifike e zjarrit jo më e madhe se 450 MJ/m² ose 25kg/m²;
- Prezenca e një fikësi zjarri të lëvizshëm, me peshë minimum 6 kg me fuqi fikëse jo më të vogël se 34A 144BC, vendosur jashtë depos, në afërsi të derës hyrëse.
- Është e lejuar të përdoren edhe ambiente që nuk i përmbushin këto karakteristika por këto ambiente duhet të kenë ngarkesë specifike të zjarrit jo më të madhe se 100 MJ/m² ose 6kg/m².

Nëse duhen depo më sipërfaqe më të madhe se 10 m² atëherë këto duhet të jenë të shkëputura me çerdhen.

6.5.3. Hapësirat e destinuara për larje rrobash dhe depozitë

Hyjnë në këtë kategori mjediset e dedikuara për impiantet e larjes së rrobave të bardha (lavatriçe, tharëse rrobash ose të ngjashme me to) dhe për depozitimin e tyre.
Karakteristikat e tyre për mbrojtjen kundër zjarrit duhet të plotësojnë të njëjtat përcaktime si ato të mësipërmet. Nuk do të merret parasysh vetëm limitimi i sipërfaqes në 10 m².

6.5.4. Impiantet Elektrike

Informacione të përgjithshme

- Gjithë impiantet elektrike duhet të projektohen dhe realizohen sipas rregullave specifike teknike në përputhje me të gjitha normativat kundër zjarrit në fuqi.
- Për të parandaluar zjarrin, duhet të kenë këto karakteritika:
  - të mos jenë faktorë në rastet e vënies së zjarrit ose të shpërthimeve;
  - të mos jenë faktorë në shpërndarjen e zjarrit;
  - të mos përbëjnë rrezikshmëri për përdoruesit si pasojë e prodhimit të tymrave dhe gazrave toksikë në rast zjarri;
  - të garantojnë pavarësinë e sistemit elektrik dhe mbajtjen në punë të sistemit të sigurisë;
  - të garantojnë sigurinë e zjarrfikësve ose të tretëve që ndihmojnë në rast zjarri.

6.5.4.1. Ndarja në seksione në rast emergjencash

- Për të garantuar mbrojtjen maksimale të punëtorëve të shpëtimit, impiantet elektrike dhe elektronike brenda çerdhes, përveç atyre për sigurinë kundër zjarrit, duhet të ndahen në seksione në rast emergjence.
- Pajisjet për seksionimin duhet të instalohen në një pozicion lehtësisht të arritshëm edhe nga skuadrat e shpëtimit, e lexueshme dhe e evidentuar me tabela, e mbrojtur nga zjarri apo nga vënia në funksion në mënyrë aksidentale.
- Elementët e qarkut të kontrollit që do të përdoren, duhet të jenë të mbrojtur nga zjarri.

6.5.4.2. Shërbimet në rast rreziku

Impiantet e mëposhtme duhet të kenë një lidhje elektrike (emergjence) sigurie:

a) ndriçimi në rast rreziku;

b) alarmi;
c) sensorët kundër tymit, gazit etj., zbuluesit;
d) impianti akustik zanor kundër zjarrit;
e) ashensori kundër zjarrit;
f) impianti i fikjes së zjarrit.

Lidhjet elektrike (emergjence) të sigurisë, duhet të realizohen sipas normave teknike në fuqi, në mënyrë që të mundësojnë kalimin automatik të lidhjes kryesore në atë të (emergjencës) sigurisë në jo më shumë se :

- 0,5 s për impiantet e mësipërme sipas shkronjave a-b-c-d;
- 15 s për impiantet e mësipërme sipas shkronjave e-f.

Autonomia funksionale e shërbimit të emergjencës, të jetë sa vijon:

- 30 minuta për impiantet e mësipërme sipas shkronjave b-c-d;
- 60 minuta për impiantet e mësipërme sipas shkronjave a-e-f.

Instalimi i impiantit rezervë duhet të jetë sipas të gjitha normave teknike në fuqi.
Aparati karikues i akumulatorëve duhet të jetë i tipit automatik dhe me kohë rikarikimi sipas rregullave teknike në fuqi.

6.6. Mjetet dhe impiantet për fikjen e zjarrit

Përcaktime të përgjithshme
Aparaturat dhe impiantet për fikjen e zjarrit duhet të realizohen dhe montohen sipas rregullave teknike, konform rregullave dhe sipas përcaktimeve të mëposhtme.

6.6.1. Fikësit

Hapësirat funksionale duhet të kenë një numër të përshtatshëm fikësish portativë sipas tipologjisë së zjarrit. Kjo tregohet në tabelën e mëposhtme:

Llojet dhe përdorimi i fikësve të zjarrit

Kategoria e zjarrit	Materialet / produktet e përfshira	Lloji i fikësve të zjarrit	Pozicionimi në çerdhe
Kategoria A	Materialet e ngurta, si druri, letra apo tekstili	Uji	Hapësirat e projektimit dhe të teknologjisë
			Në rrugët e daljes, në mënyrë që distanca në këmbë deri te fikësi i parë të mos kalojë 30m
			Laboratorët, teknologjia e ushqimit, kuzhina
Kategoria B	Lëngjet e ndezshme, si benzina, nafta / vajrat	Shkuma apo pudra e thatë	Kuzhina / teknologjia e ushqimit për zjarret e forta të yndyrës
Kategoria C	Gazrat	Kimikatet e lëngshme	Dhomat e boilerëve ku përdoren derivatet e vajit
Kategoria D	Metalet	Shkuma	Dhomat e ndërprerësve elektrikë dhe vendet ku janë të pranishme pajisjet e rrymës, psh. zonat e kontrollit të ndriçimit dhe sallat ICT

Kategoria F	Vaji i kuzhinës / vajrat me shumë yndyrë	Dioksid karboni apo pudra e thatë	Mbrojtja e automjeteve
	Automjetet	Pudra e thatë	

Fikësit e zjarrit duhet të përmbushin funksionin për sigurinë e jetës nëse mënyra më e sigurt e ikjes nga efektet e zjarrit është fikja e tij. Ata gjithashtu kanë një rol të dukshëm në mbrojtjen e pronës, nëse zjarri mund të luftohet para se të marrë përmasa të mëdha. Llojet e ndryshme të fikësve të zjarrit përdoren për llojet e ndryshme të zjarrit: në tabelë janë paraqitur llojet kryesore të fikësve të zjarrit, llojet e zjarrit për të cilët ata janë të përshtatshëm dhe pozicionimin e përgjithshëm të pajisjeve të zjarrfikjes.
Kur rreziku nga zjarri nuk është i kufizuar në ndonjë pozicion të caktuar, p.sh. zjarret e kategorisë A, fikësit e zjarrit duhet të vendosen në rrugët e daljes, afër daljes nga dhoma apo në dysheme, ose në daljen e fundit nga ndërtesa.

6.6.2. Impianti hidrik kundër zjarrit

Çerdhet me më shumë se 100 persona (fëmijë, kujdestare, drejtues etj.) duhet të kenë një impiant hidrik kundër zjarrit duke u bazuar në normativën UNI 10779:

- Niveli i rezikshmërisë: 1;
- Mbrojtje e jashtme: jo;
- Karakteristikat e furnizimit të impiantit hidrik sipas normave UNI 12845: teke.

6.7. Impiantet diktues, sinjalizimi dhe alarmi

Çerdhja duhet të ketë impiante fikse të diktimit, sinjalizimit dhe alarmit kundër zjarrit.

6.8. Sistemi i Alarmit

Çerdhja duhet të ketë sistem alarmi që të jetë në gjendje të shpërndajë sinjale në mënyra të ndryshme sensoriale:

- Sinjale akustike mundësisht të integruara me mesazhe zanore;
- Sinjale optike dhe/ose mesazhe pamore.

Procedurat e shpërndarjes së sinjalit të alarmit duhet të jenë të koordinuara me planin e emergjencës.

6.9. Tabelat informative të sigurisë

Për të lehtësuar daljen në rast emergjence duhet të montohen tabelat informative të mëposhtme:

- Tabela informative të ndriçuara, të cilat do të tregojnë daljet e emergjencës dhe korridoret e daljes. Këto tabela duhet të mbahen gjithmonë të ndezura gjatë gjithë kohës dhe të jenë të lidhura dhe me linjën elektrike të emergjencës (korridoret e daljes së sigurtë duhet të evidentohen dukshëm me ndriçim në dysheme në çdo kondicion dhe me çdo ndriçim);
- Tabela informative, në zonat ku janë prezent fëmijët, dhe që të tregojnë:
  - prezencën e shkallëve dhe/ose pengesa në rrugët horizontale;

- rrugë jo lineare;
- prezencë të elementeve konsol;

Tabelat informative, në zonat ku janë prezent fëmijët, mund të realizohen edhe me mjete të tjera (përveç tabelave informuese) si:

- Të realizohet një sistem komunikimi zanor;
- Të realizohen sipërfaqe me konsistencë të ndryshme;
- Të realizohen kontraste kromatike në dysheme të cilat janë të dukshme në të gjitha konditat e ndriçimit.

7. PARAMETRAT E KOMODOTETIT

Ekzistojnë tri burime kryesore të mungesës së komoditetit fizik që trupi mund të përjetojë: temperatura, ndriçimi dhe zëri.
Një sasi e cilës do prej këtyre jashtë gamës së pranueshme do të shkaktonte mungesë të komoditetit. Qëllimi i projektimit të ndërtesave është që mjedisi i ndërtesave të arrihet në atë mënyrë që mungesa potenciale e komoditetit të jetë në nivel të pranueshëm.

7.1Komoditeti klimatik (temperatura)

7.1.1. Përkufizimet dhe terminologjia

Komoditeti termik zakonisht i atribuohet dy parametrave kryesorë: (1) ndjenjës së komoditetit termik si rezultat i bilancit mes kalorive të akumuluara dhe të humbura në trup, dhe (2) kontrollit të kushteve klimatike, duke përfshirë pozitën e diellit dhe rrezatimit, temperaturën, lagështinë dhe erërat. Projektuesit e ndërtesave të çerdheve duhet të marrin parasysh kushtet klimatike të zonës ku parashihet të bëhet ndërtimi. Në këto udhëzime janë dhënë deklarata të përgjithshme në lidhje me kushtet klimatike në Shqipëri, por të dhëna shtesë dhe më të detajuara duhet të grumbullohen për kushtet e sakta të zonave përkatëse, siç janë: (1) minimumi dhe maksimumi i temperaturës mesatare mujore, (2) higrometria lokale, dhe (3) erërat mbizotëruese për çdo stinë klimatike dhe shpeshtësia e erërave forta dhe stuhive.

7.1.2. Përmirësimi i komoditetit klimatik

Për të përmirësuar komoditetin termik të hapësirave të çerdhes, masat e mundshme për kontrollin e klimës janë klasifikuar në dy kategori:
Masat **natyrore** ose pasive, që përfshijnë orientimin e ndërtesës, pozitën dhe dimensionet e hapjeve, cilësinë e materialeve, izolimin termik, mbjelljen e pemëve në afërsi të ndërtesave etj.
Masat **artificiale** ose aktive, që përfshijnë mjetet mekanike ose ato elektrike, siç është ngrohja, ajrosja apo kondicionimi i ajrit.
Për kontrollin e efekteve klimatike në hapësirat eçerdhes, projektuesit duhet të ndërmarrin disa masa të thjeshta në fillim të procesit të projektimit. Këto masa kanë të bëjnë me:

- **Orientimin** e ndërtesave: rekomandohet që orientimi i hapësirave të dhomave të jetë drejt jugut dhe veriut meqë ky orientim ofron mbrojtje nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ky orientim i preferuar mund të devijojë për rreth minus ose plus 30° (për shkak

të kërkesave të lokacionit, ose për shkak të orientimit të erërave mbizotëruese) pa pasur ndonjë ndikim të madh në komoditetin e dhomave mësimore (shih figurën më poshtë);
- **Vendosjen** e ndërtesave: largësia mes ndërtesave duhet të jetë në proporcion me lartësinë e ndërtesave për të lejuar qarkullimin e ajrit të pastër dhe dritën natyrore edhe në nivelet më të ulëta. Për të njëjtat arsye, një largësi minimale prej 4m duhet të mbahet në mes të faqeve kryesore dhe murit rrethues;
- **Formën dhe dizajnin** e ndërtesave, si për shembull, mundësia e rrjedhjes së tërthortë të ajrit për ripërtëritjen e ajrit të freskët me ajrosje natyrore gjatë stinës së nxehtë, ose zgjedhja e kulmit me katër nivele të pjerrësisë në zonat me reshje të mëdha të dëborës;
- **Sipërfaqet e mbjella**: mbjellja e bimëve mund të luajë një rol thelbësor në krijimin e mikroklimës, kur është e nevojshme. Mbjellja e bimëve kontribuon në mënyrë efektive në mbrojtjen nga pluhuri, erërat dhe rrezet e diellit. Përveç kësaj, mbjellja e shkurreve dhe kaçubeve bëjnë të mundur mbrojtjen kundër reflektimit të rrezeve të diellit nga toka;
- **Elementet e duhura të ndërtesës**: kjo përfshin kullimin e duhur nga çatia dhe kullimin rreth ndërtesave, krijimin e hijeve me kanate të rregullueshme nëpër dritare, ndalesa të diellit, perde për diell, çadra dhe/apo galeri që mund të sjellin mbrojtje shtesë nga rrezet e diellit, sidomos kur orientimi i ndërtesës nuk është i favorshëm.

Materialet e duhura të ndërtimit, që përfshijnë materialet e fasadave me reflektim të mundshëm të diellit, materialet izoluese për rritjen e veprimit termik të mureve dhe të kulmit, me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

7.1.3. Kontrolli aktiv i klimës

- **Temperaturat e ulëta:** niveli komod i temperaturave më të ulëta mund të konsiderohet ai mes 19°C, për vendet ku ushtrohen veprimtari të punës që nuk përfshijnë lëvizje, dhe 15°C, për zonat e qarkullimit. Përpjekjet për të siguruar nxehtësi në mënyrë që të arrihen këto nivele të temperaturave në mjediset e brendshme, zakonisht nuk duhet të jenë shumë të larta. Megjithatë, një minimum shumë më i ulët mund të ndodhë në secilin prej muajve të sezonit të ngrohjes, ku sistemi i ngrohjes duhet të ketë kapacitetet të reagimit ndaj këtyre temperaturave të ulëta.

- **Temperaturat e larta**: Klima e Shqipërisë është kryesisht e thatë dhe e nxehtë nga maji deri në shtator, ku shumica e ditëve gjatë kësaj periudhe janë me diell. Muajt më të nxehtë janë korriku dhe gushti me variacione rajonale për shkak të lartësisë. Megjithatë, temperaturate ajrit 26°C është kufiri për punë komode në çerdhe, ku me lëvizjen e duhur të ajrit nga rrjedha e ajrit natyror, nga dritaret e hapura dhe qarkullueset e ajrit, këto nivele zakonisht mund të arrihen në dhomat gjatë vitit.

7.1.4. Temperatura dhe nivelet e lagështisë

Në çerdhe kështillohet që niveli i temperaturës dhe i lagështisë të jetë sipas përcaktimeve të mëposhtme (matur në një lartësi 90cm nga niveli i dyshemesë):

- **Dimër:** 21°C; 35 % minimumi i lagështisës relative;
- **Verë:** 24-26°C; 50 % maksimalja e lagështisë relative.

Në dimër, në zonat e ndërrimit të latantëve ose motakëve, këshillohet një temperaturë më e lartë nga mjediset e tjera nga 1 deri në 3°C.
Në tabelën e mëposhtme jepen grafikisht informacione që sjellin një kombinim pozitiv midis temperaturës dhe lagështisë relative në mënyrë që të mos ketë efekt të kondensimit,i cili do të sillte prezencën e mykut në mure.



Grafik me të dhënat e raportit Lagështi /Temperaturë sipërfaqësore të elementeve konstruktive

7.1.5. Standardi i izolimit

Sa më i mirë të jetë termoizolimi i një elementi konstruktiv të jashtëm përballë ajrit të jashtëm, aq më e vogël është mundësia e daljes së ajrittë ngrohtë jashtë.
Elementët konstruktive të izoluara keq, kanë temperaturë të ulët të sipërfaqeve të brendshme; sa më i keq të jetë ky izolim aq më i madh është rreziku që në sipërfaqe nën ndikimin e një lagështie të shëndetshme relative të ajrit prej 40-60%, temperature kritike minimale zbret nën 12,6 °C.
Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet zonave të ashtuquajtura ura termike si p.sh. tavanet e mureve të jashtëm, pasi këtu temperatura e sipërfaqes mund të jetë më e ulët se sa ajo e elementeve konstruktive në zonat e rregullta.

7.1.5.1. Urat termike

Urat termike janë pika të dobëta termike të lokalizuara në mbulesën transmetuese termike të ndërtesës. Në krahasim me sipërfaqet e pashqetësuara të elementeve konstruktive, në këto pika ndodh një humbje e madhe termike nga brenda jashtë. Sa më i lartë standardi energjitik i një ndërtese, aq me rëndësi është eleminimi i urave termike.

- **Llojet e urave termike**

  - Urat termike gjeometrike të kushtëzuara krijohen, nëse madhësia e sipërfaqeve thithëse dhe çliruese termike ndryshojnë, si p.sh. në këndet e jashtme të ndërtesës, trashësitë e ndryshme të elementit konstruktiv ose kollonave të dala.
  - Urat termike të kushtëzuara nga lloji i materialit krijohen gjatë përdorimit të materialeve me përçueshmëri të ndryshme termike dhe me këto karakteristika të ndryshme izoluese, të cilat mund të janë të vendosura në krah ose mbi njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, në vendin e materialit të ndërtimit me përçueshmëri më të lartë termike krijohet një rrymë termike më elartë. Një shembull tipik janë elementet konstruktive prej betoni brenda një muri të jashtëm me tullë.
  - Urat termike konvektive krijohen kur energjia termike e një rryme ajri transportohet nëpërmjet mbulesës së ndërtesës përçuese termike. Ato shkaktohen nga mos hermetizimet e sipërfaqes. Bashkimet e hapura të shtresës izoluese në zonën e çatisë apo mosizolimi i fugave të dritareve janë shembuj të krijimit të këtyre urave termike.

Një numër i madh i urave termike mund të mënjanohen nëpërmjet punës së mirë projektuese, supervizimit të kujdesshëm dhe nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve të duhura.

- **Këshilla gjatë projektimit**
  - Të mënjanohen strukturat me shumë degëzime;
  - Të vendosen ndarje termike të elementeve konstruktive konsol (pllakat e ballkonit, kollonat, konsolat mbajtëse) me strukturat në kufi;
  - Shtresa të pandërprera të materialit izolues p.sh. sistemet termozioluese të mureve të jashtme dhe kalimet e niveleve të veçanta izoluese pa dobësim të vlerave termoizoluese.





Llojet e urave termike

7.1.6. Kërkesa e vlerave të U(W/m²K)(koeficientii transmetimit termik)

Në ndërtimet e çerdheve këshillohet që të ruhen këto vlera të U-së në struktura e ndryshme:

Llojii elementit konstruktiv	Kërkesat Vlera-U (W/m²K)	
	Izolimi i brendshëm	Izolimi i jashtëm
Mure të jashtme	0,35	0,35
Mure bodrumi nëntokë Mure të brendshme që mbeshtetën nga anojnë në pahijeuara	0,50	0,40
Çatia e pjerët	0,20	
Tavani i katit të sipërm nëntoka ambient nëntoka të papërshirur	0,20	
Tavani midis mbibodrumit e papërshirur	0,60	0,80
Dyshemeja bodrumi nëntokë	0,50	0,40

Vlerat U të këshillueshme sipas pozicionit të strukturës

Në rastin e çerdheve rëndësi të vecantë duhet t'i kushtohet trajtimit të dyshemesë. Duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e fëmijëve, sidomos motakët dhe latantët, kalojnë një pjesë të

madhe në kontakt me dyshemenë, atëherë vëmendje të veçantë i duhet dhënë zgjidhjes së saj teknike dhe shtresave veshëse. Përveç këtyre kërkohet që sipërfaqet e dyshemeve të vishen me tapa, me tapete të trasha ose me linoleum të trashë dhe me nivel të lartë izolimi termik.

7.1.7. Dritaret dhe Dyert

7.1.7.1. Dritaret

Depërtimi i dritës natyrale në mjediset e brendshme, fushëpamja e lirënga brenda jashtë ndërtesës dhe fushëpamja e lirë brenda të gjithë ndërtesës janë elementemjaft të rëndësishme në Mjediset për fëmijë.
Dritaret duhen vendosur si në muret që ndajnë dhomat nga Mjediset e jashtme, dhomat nga dhomat dhe dhomat me korridorete brendshme.
Për të përmbushur këto kërkesa duhet të merren parasysh si fëmijët ashtu edhe kujdestarët e rritur. Duhet t'u kushtohet rëndësi elementeve si lartësia dhe kornizat e dritareve, lloji i xhamit, qartësia e pamjes (të mos të bllokohet horizontalisht si nga të rriturit ashtu edhe nga fëmijët), kontrolli i dritës, impakti i vlerësimit të riskut, si dhe faktorët e sigurisë. Vlerësimi i sigurisë mund të rekomandojë që stacioni i rojës të pozicionohet brenda qendrës në mënyrë që hyrjet dhe daljet të mund të monitorohen nga rojet e ndërtesës. Ose mund të rekomandohet ndonjë formë alternative për këtë. Projektuesi duhet të përpiqet që të planifikojë të paktën një dritare të jashtme për klasë. Në rast se kjo nuk mund të bëhet por hapësira e brendshme duhet të zihet nga fëmijët, projektimi duhet të parashikojë depërtimin më të mirë të dritës dhe pamjes nëpërmjet vetratave, dritareve anësore, dritareve dhe dyerve me xham (të sigurta). Hapësirat e fëmijëve në ndërtimet e reja duhet të kenë një sipërfaqe totale me dritare prej së paku:

- 8 % të sipërfaqes së dyshemesë nëse dritaret janë nga jugu dhe lidhen drejtpërdrejt me Mjediset e jashtme.(Shënim: sipërfaqja e xhamit që sheh nga jugu është më e vogël pasi cilësia e dritës që vjen nga jugu është më e mirë.);
- 10% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret orientohen nga lindja apo perëndimi;
- 15% të sipërfaqes së dyshemesë së dhomës nëse dritaret shohin nga veriu;
- 20% e sipërfaqes së dhomës nëse dritaret nuk janë në një mur të jashtëm.

Sipërfaqet që nuk kanë nevojë për dritare janë tualetet, zonat e kuzhinës, dhoma e larjes së rrobave, ato me shumë përdorime, zyrat, dhoma e konferencave, holli dhe depot.
Nuk lejohet vendosja e skarave metalike në dritare.

7.1.7.2. Montimi i dritareve

Në objektet e reja, dritaret nga këndvështrimi energjitik, paraqesin pikën më të dobët.
Për shkak të dritareve me izolim jo të mirë ndërmjet xhamave dhe fugave të dritares, humbjet energjitike janë të mëdha.
Për ndërtimet e reja këshillohet për dritaret, dyert një vlerë U më e lartë. Si rregull sot vendoset dopio xham (veshje me xham termoizolues) me Vlerë U prej 1.2 (W/m^2K).
Përveç kësaj mund të vendosen në zona të ftohta, dritare me tre shtresa xhami me dhoma izoluese dhe me profile me shumë dhoma. Dritarja në këtë rast këshillohet të arrijë një vlerë U prej 0.8 (W/m^2K).
Krahas një vlere U-je të ulët duhet që veshja me xham të provojë nje vlerë të lartë të izolimit ndaj rrezeve të diellit (g). Kjo vlerë specifikon sa i lartë është rrezatimi diellor, i cili depërton

nëpërmjet xhamit dhe ndihmon kështu në ngrohjen e ndërtesës.Tek xhamat e sotëm të dritareve të termoziluara kjo vlerë këshillohet rreth g = 60%.
Gjatë zgjedhjes të kornizës së dritares vlen të konsiderohet:

- Humbjet e energjisë përmes kornizave prej druri dhe plastike janë më të vogla se kornizat prej metali.
- Në kalimet ndërmjet xhamit dhe kornizës krijohen hapësira, të cilat rezultojnë në humbje ekstra të energjisë.
- Shpesh kornizat janë prej alumini, një material me aftësi të lartë transmetuese të nxehtësisë.

Urat termike dhe kondensimi, si problematikë e lidhur me të, përforcojnë këshillimin e përdorimittëvazhdueshëm të dritareve me kornizë plastike, druri.

7.1.7.3. Informacione për montimin e dritareve, dyerve

Për të shmangur urat termike, duhet që dritarja të montohet nën nivelin e termoizolimit ose të paktën të montohet në këndin e jashtëm të murit. Izolimi kështu vendoset mbi kornizën e dritares. Duhet të kihet patjetër kujdes që gjatë momentit të montimit të realizohet një bashkim hermetikisht i vazhdueshëm i dritares. Montimi me ndihmën e shkumës nuk është i mjaftueshëm, meqenëse ajo në fazën e tharjes mblidhet dhe kështu nuk garanton më një izolim hermetik.



Montimi i këshilluar i dritareve dhe dyerve

7.1.8. Kontrolli pasiv i klimës

Kontrolli mbi depërtimin dhe krijimin e nxehtësisë mund të minimizohet në mënyrë të natyrshme duke projektuar si duhet muret dhe suvatimine ndërtesës. Burimi i nxehtësisë është dielli, ndaj përjashtimi i dritës së drejtpërdrejtë të diellit nga ana e brendshme e ndërtesës është esenciale. Siç përmendet më lart, muret e jashtme mund të anashkalohen si burim i rëndësishëm i krijimit të nxehtësisë së brendshme gjatë ditës në çerdhe. Kjo do të thotë se dritaret janë elemente që kërkojnë vëmendje. Kjo arrihet në dy mënyra:me orientim dhe reflektim të diellit.Duhet të theksohet se mjetet për krijimin e hijeve nga dielli brenda xhamit nuk janë të efektshme meqënëse materiali ngrohet dhe krijohen reflektime në brendësi. Është thelbësore që të ndalohet goditja e diellit në xham, nxehtësia nuk reflektohet jashtë përmes xhamit, meqënëse gjatësia valore ndryshohet dhe ambienti ngrohet. Duhet të theksohet se përdorimi i lustrimit të dyfishtë është i paefektshëm për ndalimin e depërtimit të diellit, kjo është efektive në parandalimin e humbjes së jashtme të nxehtësisë.

- **Orientimi për diellëzimin**: drejtimi, ose orientimi më i mirë për të pasur dritë natyrale gjatë ditës në dritare është veri-jug (shiko figurën më poshtë): Orientimi nga Veriu në Shqipëri nuk reflekton drejtpërdrejt dritë të diellit në krahun e dritares, ndërsa orientimi nga Jugu reflekton rreze minimale, në dritare nën këndin më të vogël dhe të ngushtë gjatë ditës: në pjesën më të nxehtë të ditës, dielli do të jenë në zenit dhe këndi i rrezatimit të dritareve drejt jugut do të jetë më i ngushti.



Orientimi i rekomanduar i çerdhes

- **Ajrosja (ventilimi i tërthortë)** do të jetë një faktor natyror i komfortit për pjesën më të nxehtë të vitit (shiko figurën më poshtë) por në pikat më të larta mund të ketë më shumë nevojë për të nxjerrë jashtë ajrin që është ngrohur duke kaluar nëpër tokë të ngrohtë e të thatë. Sidoqoftë, ndërtesat me hapësira me opsion të hapjes në të dy anët, nuk janë ekonomike, ndonëse kjo mënyrë rekomandohet si më optimale. Çerdhja, si çdo grup ndërtimi tjetër, do të ketë një pjerrësi të shtypjes në kushte dhe drejtime të ndryshme të erës, në mënyrë që ajri të qarkullojë nëpër ndërtesë nga shtypja pozitive dhe negative, deri në atë masë që mundësohet nga ndarjet dhe hapësirat e brendshme. Në këtë mënyrë

bëhet freskimi i mundshëm gjatë natës, e që të ndihmohet nga dritat e jashtme që futen nga dritaret e jashtme të nivelit të sipërm.



Komoditeti Termik / Ventilimi i ërthortë

- **Reflektimi i diellit**: pajisje efektive për reflektimin e diellit mund të projektohen për të funksionuar në çdo orientim, meqënëse këndi i diellit është plotësisht i parashikueshëm. Megjithatë, për shkak të ndryshimit sezonal në lartësi, përjashtimi i rrezeve të diellit gjatë vitit do të kërkojë elemente të lëvizshme. Në praktikë, reflektimi është zakonisht një kompromis, edhe në qoftë se është projektuar orientimi optimal, reflektimi pas realizimit do të jetë efektiv. Duke supozuar orientimin nga jugu, dritarja do të reflektohet nga një raft i jashtëm horizontal në nivel të majës së dritares, me projektim që varet nga kohëzgjatja e vitit që dëshirohet për t'i parandaluar rrezet e diellit që të hyjnë në sallë apo që të bien në dritare. Gjatë dimrit, do të ketë përfitime nga rënia e diellit, kështu që këndi i rënies së diellit që duhet të përjashtohet është ai prej majit deri në tetor. Ka rëndësi thelbësore evitimi i rënies së rrezeve të diellit në dritare pasi nxehtësia është shumë e efektshme kur mjedisi dhe vetë xhami nxehet, duke e rritur kështu efektin e ngrohjes. Duhet të theksohet se përdorimi i xhamave të dyfishtë është i paefektshëm në ndalimin e diellit, dhe është efektiv vetëm në parandalimin e humbjes së diellit nga jashtë. Ndërtimi i një kulmi të madh të dalë jashtë apo masa e dritareve me grila janë pjesë e zgjidhjeve të zakonshme të mbrojtjes ndaj diellit (shih figurën më poshtë).



Komoditeti termik / Mbrojtja nga dielli

7.2 Komoditeti vizual

Përkufizimet dhe terminologjia

Nevoja për standarde të larta dhe një ndriçim i projektuar mirë për ndërtesat e çerdheve bazohet në:

- **ndriçimin natyror** që rezulton nga drita e diellit e drejtpërdrejtë apo ajo e reflektuar nga toka dhe sipërfaqet e tjera të jashtme apo ato të brendshme;
- **ndriçimin artificial** nga burimet e rrymës elektrike (llambat, tubat fluoreshentë);

- **shkëlqimin** apo intensitetin e dritës qoftë nga burimi natyror apo ai artificial apo nga ndonjë sipërfaqe ose objekt i padepërtueshëm që nuk është transparent;
- **kontrastin** e shkëlqimit apo ngjyrës.

Faktorët mesatarë për reflektimin e dritës

Materialet	**%**
Allçi	85
Letra e bardhë	84
Lyerja e bardhë	75
Çimentoja	55
Gurë gri	50
Lënda natyrore e drurit (ngjyrë e lehtë)	33
Tullat e kuqe	20

Ndriçimit duhet t'i kushtohet shumë rëndësi për çdo zonë veprimtarie pasi është element kyç për të krijuar një ambient sa më të ngrohtë.
Cilësia e dritës duhet t'i krijojë ndjesinë fëmijëve se janë si në shtëpi.
Ndriçimi i madh është më i përshtatshëm për hapësira ku kryhen veprimtari motorike; ndërsa ndriçimi me fokus mbi një detyrë specifike nevojitet për veprimtari manipulative; ndriçimi më i dobët duhet përzonat e qeta dhe të gjumit.
Sasia dhe orientimi i dritës natyrale duhet të merret parasysh në projektimin dhe variacionin në nivelin e dritës.
Në dhomat me ndriçim të varfër natyral lejohet një maksimum prej 500 lx. Dhomat që nuk kanë dritare në tavan apo dritare të jashtme, duhet të pajisen me tuba përcjellës së dritës natyrale.
Hapësira dritash të cilat e tejçojnë më thellë dritën në brendësi mund të përdoren në tërë faqet nga jugu. Projektuesit mund t'i referohen tabelës për vlerat minimale të dritës për funksione të ndryshme.
Për më tepër duhet të mbahet parasysh sa vijon: Me dritën e pasqyruar, fëmijët (të cilët janë në pikën me fushëpamje më të ulët se të rriturit) nuk do të shohin në mënyrë të drejtpërdrejtë burimin e dritës, një kusht ky që shkakton shkëlqim verbues dhe lodhje të syrit. Dritat me fokus si ato të varurat të tipit rezidencial, duhet të përdoren kur lexohet, pikturohet dhe bëhet punë e imët. Projektimi i shumëllojshmërisë në ndriçim me mjete si kontroll të nivelit të dritës, çelës të veçantë, kabllo me orientim të rregullueshëm dhe kabllo të varur duhet të vendosen në zonën e punës. Mund të provohet të vendoset ndriçim specifik për të paraqitur vepra të ndryshme arti, abazhurë me shumë llamba për të krijuar një atmosferë të gëzueshme dhe nivele të larta dritash për të nxitur veprimtarinë fizike.

Zonat e përgatitjes së ushqimit duhet të kenë llamba fikse apo të pathyeshme.
Drita e jashtme duhet të kontrollohet nëpërmjet kondraperdeve apo llojeve të tjera të mbulimit të dritareve. Këto masa duhet të mundësojnë shikueshmëri të qartë. Ndriçimi i jashtëm duhet të jetë i mjaftueshëm që të mundësojë qarkullim dhe siguri. Të gjitha llambat duhet të kenë lente apo mbulesa për t'i bërë rezistente nga thyerja.

Lux i këshillueshëm në pjesën e dhomave

HAPËSIRA	NDRIÇIMI	NDRIÇIM NË LUX
Zona e aktivitetit të fëmijës	Ndriçim natyral	400 - 500
Ushqimi	Ndriçim natyral	300 - 500
Gjumi		50 - 500
Zona e ndërrimit të pelenave		300 - 500
Zona e magazinimit		300 - 500
Tualeti i fëmijëve		300 - 500
Lavamani ku fëmijët lajnë duart		300 - 500

Lux i këshillueshëm në pjesën e administratës

HAPËSIRA	NDRIÇIMI	NDRIÇIM NË LUX
Salla e pritjes	Ndriçim natyral	250 - 350
Recepsioni	Ndriçim natyral	250 - 350
Qarkullimi kryesor / Korridori/ Holli		150 – 350
Zyra e drejtuesit	Ndriçim natyral	500
Salla e personelit	Ndriçim natyral	500
Salla e takimeve prindër/kujdestare		500
Tualeti i të rriturve		150 – 250
Depo qendrore		250 – 350
Lavanderia		300 – 400
Kuzhina		300 – 500
Hapësira polifunksionale		300 – 400
Zona e lojës	Ndriçim natyral	400 – 500

7.3. Komoditeti akustik

Në ndërtesat e çerdheve një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet izolimit akustik. Në nivel urban pozicionimi i çerdhes, siç është trajtuar më lart, duhet të jetë në zona të qeta larg akseve të rëndësishme rrugore. Preferohet që pozicionimi i tyre të bëhet në brendësi të zonës së banimit.
Në raste kur kjo gjë nuk është e mundur atëherë zgjidhjet janë të ndryshme, qoftë me barriera fizike si mure, qoftë me barriera fizike të gjelbërta si bimësi të lartë.
Në brendësi të çerdhes strukturat duhet të garantojnë një izolim akustik të specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Elemente konstruktive	Kërkesat e R'w në dB
Mure ndërmjet ambienteve të dhomave dhe ambienteve të ngjashme	47
Mure ndërmjet ambienteve të dhomave dhe korridoreve	47
Mure ndërmjet ambienteve të dhomave ose ambienteve të ngjashme dhe shkallëve të ndërtesës	52

Mure ndërmjet ambienteve të dhomave ose ambienteve të ngjashme dhe ambienteve "veçanërisht të zhurmshme" (p.sh. kuzhina, Mjediset e administratës)	55

Në mënyrë të veçantë këshillohet që disa zona specifike si p.sh. zona e fjetjes, që kanë nevojë për më shumë izolim, të kenë këto nivele izolimi akustik **R'w** i matur në **dB:**

Mjediset	**Kërkesat e R'w në dB**
Zona e fjetjes	60

Është e këshillueshme që gjatë projektimit të impianteve dhe të strukturave të tjera të merren parasysh këto rekomandime:

- Të gjitha tubacionet (ajrit të kondicionuar, furnizimit hidrik) që përshkojnë muret që tejçojnë zhurma duhet të vishen me material për mbrojtje akustike;
- Në Mjediset ku mendohet se mund të krijohen nivele akustike të larta të vendosen elemente të mobilimit të tilla që të ndihmojnë në uljen e niveleve akustike si p.sh. në korridorre të vendosen linoleum, tapet etj;
- aty ku mundet suvatimi të jetë me materiale që zbusin nivelin akustik;
- për të ulur nivelet akustike, gjatë projektimit të mendohet të përdoren materiale për të zbutur zhurmat brenda çerdhes;
- xhamat e dyerve dhe dritareve duhet të jenë qelq i laminuar akustikisht me një aftësi izolimi akustik 35dB, me hapësirë ajri nga 50mm deri në 100 mm;
- dyert që hapen nga zonat e zhurmshme duhet të sigurojnë një izolim të lartë akustik
- këshillohet të përdoren materiale tekstile për të ulur nivelin akustik;
- për të izoluar sa më mirë zonën e dhomave me pjesën e jashtme apo me pjesën e administratës mund të përdoren edhe dopio dyer ose sistemi tambur. E njëjta gjë këshillohet edhe për dritaret në zgjidhjen e dritareve dopio. Kjo zgjidhje ndihmon edhe për të arritur një izolim më të mirë termik duke pasur parasysh që dyert dhe dritaret janë dhe zonat më delikate në kuptimin akustik edhe termik;
- kutitë e prizave elektrike nuk duhet të instalohen me kurriz.

Arritja e mbrojtjes nga zhurma brenda një objekti nuk varet vetëm nga masa e transmetimit të zërit në elementekonstruktivee ndarës, por gjithashtu edhe nga masa e zëizolimit gjatësor i elementeve konstruktive të anashkruara. Megjithatë kjo lidhje në praktikë shpesh lihet jashtë vëmendjes. Kush mjaftohet me zëizolimin në një objekt vetëm nga vlera të veçanta të elementeve konstruktive ndarëse vjen në një rezultat jo të mjaftueshëm, pasi zëizolimi gjatësor i elementeve kontruktive të anashkruara përcakton kufirin e performancës në zëizolim. Vetëm një pikë e dobët në izolimin e elementeve të anashkruar (p.sh. pllaka të pandërprera të shtresës së dyshemesë, elemente të lehta të fasadës, mure prej tullave me vrima) ezvogëlojnë masën e rezultuar të zëizolimit, sa që ndryshimet në masën e zëizolimit të elementevekontruktive ndarëse e bëjnë të parëndësishme.
Planifikimi me përgjegjësi fillon së pari me arritjen e qartësimit të masës zëizoluese të elementeve konstruktive të anashkruara dhe në këtë fushë të arrihen kushtet e nevojshme për rezultate pozitive të zëizolimit gjatësor në ndërtesë. Më pas duhen të zgjidhen mure ndarëse në përshtatje me rrethanat.

8. NGJYRAT DHE PËRDORIMI I TYRE

8.1Kuptimi i ngjyrave

Ngjyrat ndikojnë te fëmijët në mënyra të ndryshme duke i bërë të ndihen të lumtur, të mërzitur, të qetë ose meditativë. Ngjyrat ndikojnë në perceptimin e madhësisë së ambientit, komoditetit etj.
Ngjyra mund të ndryshojë perceptimin tonë për dimensionet dhe distancën. Një mur i lyer në nuancë më të errët apo ngjyrë më të ngrohtë do ta afrojë atë duke e bërë të duket më afër se ç'është në të vërtetë. Kjo vjen në ndihmë kur lyhen muret në fund të korridoreve të ngushta.
Në rastet e një ambienti të vogël duhet të përdorenngjyra të hapura dhe me tonalitete të ftohta.
Për këtë arsye përdorimi i tyre në çerdhe është i domosdoshëm, por duhet edhe të kihen parasysh ndikimet e tyre te fëmijët.

- ***E kuqja*** lidhet me diellin dhe mund të shtojë rrahjet e zemrës. Është një ngjyrë mjaft stimuluese dhe simbolizon veprimtaritë dhe dëshirën për jetën, si dhe ngrohtësi.
- ***Portokallia*** është një version më pak i fortë se e kuqja . Krahasohet me gëzimin që ngjall e verdha. Jep gëzim dhe ndihmon në kapërcimin e traumave. Përfaqëson natyrën me diell dhe të bukur.
- ***Bluja*** në terapinë e ngjyrave njihet si ngjyra e tranzicionit, Bluja ofron përkrahje dhe mbrojtje dhe është ngjyra e paqes, qetësisë dhe zgjuarsisë.
- ***Roza*** si bluja ka efekt qetësues dhe sugjeron ngrohtësi dhe qetësim.
- ***E gjelbra*** është ngjyra e rinisë, rritjes, shpresës, gëzimit, jetës dhe freskisë. Është gjithashtungjyra e harmonisë dhe ekuilibrit.
- ***E verdha*** është një ngjyrë optimizmi dhe është efikase si një ngjyrë stimuluese diellore. Sjell qartësi

Fëmijët, në veçanti, kanë nevojë për një ambient dinamik dhe stimulues për të rritur dhe formuar intelektin e tyre.
Dhomat me ngjyrë portokalli, jeshile ose bojëqielli i shoqërojnë në një dimension didaktik, stimulojnë aktivitet e tyre sensoriale dhe i qetësojnë ata.
Në teorinë e përgjithshme të ngjyrave ndarja e parë bëhet midis tonaliteteve të ngrohta dhe atyre të ftohta.
Në tonalitetet e ngrohta kategorizohet ngjyra e verdhë, e kuqe, portokallia dhe të gjithë tonalitetet e ndërmjetme. Këto janë ngjyra aktive, pozitive dhe lidhen me aksionin, me tingujt e lartë dhe me lëvizjen e vazhduar. Nga një eksperiment është vënë re se zemra rreh më shpejt në një dhomë me ngjyrë të kuqe se nënjë me ngjyrë bojëqielli.
Tonalitetet e ftohta janë bojëqielli, blu, e purpurt, të cilat janë ngjyra të qeta, pasive që stimulojnë meditim dhe qetësi.

- Në hapësirat që kanë funksion loje dhe pune aktive, janë të këshillueshme ngjyrat dhe tonalitetet e ngrohta midis të verdhës së lehtë, të verdhë në portokalli ose portokalli të hapur sepse stimulojnë prodhimin e adrenalinës, dhe për rrjedhojë ndikojnë në krijmtarinë dhe në kapacitetet motorike.
- Në zonat e ngrënies ose në zonat e gjumit preferohen ngjyrat dhe tonalitetet e ftohta, sepse në pikëpamjen fiziologjike, një mjedis me tonalitete jeshile-blu-bojëqielli, ndikojnë në uljen e rrahjeve kardiake duke sjellë ndjesi qetësie.

8.2 Përdorimi i ngjyrave

Para se të mendohet për ngjyrat specifike, është e rëndësishme të përcaktohet se sa dritë natyrale ka ambienti. Të identifikohen zonat e vogla dhe të vështira. Të përcaktohet funksioni që kanë dhomat dhe zonat, më pas të përcaktohet atmosfera që dëshirohet të krijohet, pra nëse duhet e ftohtë dhe harmonike apo e ngrohtë, mikpritëse apo e rehatshme.
Ngjyrat duhet të zgjidhen me kujdes për të krijuar ekuilibrin emocional. Veprimtaritë që ndodhin në zona të ndryshme do të kërkojnë skema të ndryshme ngjyrash dhe duke e mbajtur skemën kryesore të ngjyrave të butë, mund të përdoren ngjyra më të forta e më të ndezura në zona si dyer, dritare, cepat dhe kornizat. Si zgjidhje për të mbajtur ekuilibrin, një nga rrugët më të thjeshta e më të suksesshme është përdorimi i dy, tre apo më shumë ngjyrave që qëndrojnë pranë e pranë në prizmin e ngjyrave, si: pjeshka, kajsia dhe portokallia, apo e gjelbra, e gjelbër në blu, akuamarina dhe e kaltra.
Përdorimi i këtyre skemave quhet përzierje apo harmoni, sepse të gjitha ngjyrat janë të kombinuara, të balancuara duke mos përplasur dy ngjyra.
Nëse kërkohet një atmosferë e qetë dhe e freskët atëherë duhet të zgjidhen ngjyra të gjelbra, si blu në të gjelbër apo blu të gjelbra. Nëse atmosfera duhet e ngrohtë atëherë kjo arrihet me anë të ngjyrës së kuqe, rozë, portokalli dhe të verdhë.

9. MOBILIET

Në mobiliet do të përfshihen objekte fikse ose të lëvizshme, që organizojnë hapësirat e brendshme dhe të jashtme, duke lejuar përkujdesjen më të mirë për fëmijët dhe zhvillimin e aktiviteteve të lojës dhe të të mësuarit.
Në përzgjedhjen e mobilieve duhet të mbahen parasysh këto kritere:

- funksionaliteti;
- siguria;
- vendosja e saktë në zona të ndryshme;
- lehtësi përdorimi për të mëdhenjtë dhe të vegjlit;
- higjienë dhe lehtësi pastrimi.

Duhet të kihet parasysh gjithashtu që mobiliet e zonave të ndryshme duhet të jenë më së shumti:

- tavolina me këndë të zmusuara (me diametër jo më pak se 13mm);
- ulëse të përshtatshme për moshën me mbështetëse dhe ndenjëse ne formë anatomike;
- dollape të vegjël, lehtësisht të aksesueshëm nga të vegjlit për të depozituar gjërat e tyre personale, lodrat dhe materialet didaktike;
- suprina të vendosura në lartësi, për objekte që duhet të jenë larg fëmijëve, që përbëjnë rrezikshmëri. Të jenë të aksesueshme nga kujdestaret;
- djep dhe krevate personale lehtësisht të pastrueshme;
- ulëse për fëmijët e vegjël.

Mobiliet duhet t'i përgjigjen kritereve ergonomike në mënyrë të rreptë. Kjo gjë do të siguronte një qëndrim të saktë të fëmijës gjatë uljes dhe do të mënjanonte dëme muskulare - skeletike te fëmijët.
Për zonën e gjumit krevatet duhet të kenë krahë anësorë për latantët, kurse për motakët dhe të rriturit krevatet dhe dyshekët duhet të jenë lehtësisht të aksesueshëm.

Mobiliet duhet të realizohen me materiale që duhet të jenë joalergjike apo të dëmshme për shëndetin e fëmijës.

Çerdhet duhet të kenë edhe mobilie të sigurta dhe të qëndrueshme për aktivitete dhe lojëra të ndryshme si (rëra, mielli, piktura të bëra me bojë jotoksike dhe me bazë uji, kavaleta etj.).

Këshillohet që mobiliet të jenë me material të riciklueshëm, lehtësisht të pastrueshëm (preferohet pisha ose bredhi si material primar për mobiliet) dhe antialergjik.
Më poshtë jepen tipet dhe sasia e këshillueshme e mobilieve për çdo zonë:

9.1 Dhoma e latantëve (mobilie të rekomanduara)
(të gjitha orenditë duhet të jenë anatomike nga forma dhe me materiale antialergjik)

- **Zona e fjetjes**

- Krevati dhe dysheku (1 për fëmijë);
- Karrige tundëse për të rritur (1 për 4 fëmijë);
- Krevat evakuimi me rrota dhe dyshek (1 për 4 fëmijë);
- Pastrues ajri;
- Gardh me gjysmë lartësi dhe mur ndarës mes zonës së lojës dhe asaj të gjumit.

- **Zona e ndërrimit të pelenave**

- Kosh për hedhjen e pelenave me pedale ose me kapak hapës automatik (i preferueshëm);
- Rafte të ndarë mbi tavolinën e ndërrimit të pelenave;
- Gardh me gjysmë lartësi mes zonës së lojës dhe tavolinës së ndërrimit të pelenave.

- **Zona e relaksit**

- Jastëk për sheshin (1 për fëmijë);
- Pasqyrë horizontale sigurie me/pa kornizë druri (1);
-Tapet në dysheme (2);
- Rrugicë me ngjyra të forta (2);
- Jastëkë gjeometrikë (2);
- Karrige me mbushje të butë (2);
- Varëse me pasqyrë për të marrë një pamje totale të fëmijëve 609 mm i lartë (1);
- Dollap depo prej druri (2);
- Divan i vogël ose dyshek me dimensione të vogla (2);
- Dollap murinë lartësi për të rriturit (2).

- **Zona e lojës**

- Karrige druri (1 për fëmijë) me dimensione që ndryshojnë 127-152 mm;
- Tavolina të larta druri (1 për 4 fëmijë) me lartësi 304-355 mm;
- Ndarje të brendshme mes zonës së ecjes këmba-doras dhe zonës së ngrënies;
- Soba me mikrovalë, larësi i enëve/sterilizuesi (për të dezinfektuar lodrat);
- Frigorifer me depo për ruajtjen dhe kyçjen e ilaçeve 609 mm i lartë;
- Tavolina plastike për fëmijë 609 mm tabelë prej tape (2);
- Ngrohës biberonash (2).

- **Zona aktive**

- Piramidë bukë-peshku përfshirë rrëshqitëse, lexues kompakt disku, pedanë e vogël me tapet;
- Pedanë e madhe me tapet, vitrinë fotosh, raft për fëmijët;
- Dollap këpucësh (2).

9.2 Dhoma e Grupit II (motakët), (mobilie të rekomanduara)
(të gjitha orenditë duhet të jenë anatomike nga forma dhe me materiale antialergjik)

- **Zona e pelenave**

- Kosh për hedhjen e pelenave me/pa kapak me pedale;
- Rafte të ndarë mbi tavolinën e ndërrimit të pelenave;.
- Gardh me gjysmë lartësi mes zonës së lojës dhe tavolinës së ndërrimit të pelenave;
- Tavolinë për ndërrimin e pelenave me/pa shkallë.

- **Zona e Relaksit**

- Jastëk për sheshin (1 për fëmijë);
- Pasqyrë horizontale sigurie me/pa kornizë druri;
- Tapet në dysheme (2);
- Rrugicë me ngjyra të forta (2);
- Jastëkë gjeometrikë (2);
- Karrige me mbushje të butë (2);
- Varëse me pasqyrë për të marrë një pamje të fëmijëve 609 mm i lartë;
- Dollap depo prej druri (2);
- Divan i vogël ose dyshek;
- Dollap druri në mur (3);
- Karrige tundëse për të rritur;
- Pastrues ajri;
- Depo apo raft i ulët për librat e bebeve (2).

- **Depo/Hyrja**

- Karrocë dyshe me palosje e mbuluar;
- Karrocë për shumë fëmijë (1 për 4 ose 6 fëmijë);
- Tabelë e bardhë me fshirësen përkatëse;
- Depo me çelës për sendet personale të kujdestareve;
- Depo personale për çantat e pelenave;
- Raft me ndarje kutish për njoftimet për prindërit;
- Tabelë për shënime në varësi të vendndodhjes dhe këndit të lodrave.

- **Zona e lojës**

- Karrige druri (1 për fëmijë), dimensionet ndryshojnë 152-165 mm;
- Tavolina të larta druri (1 për 4 fëmijë) me lartësi 355 mm;
- Soba me mikrovalë, larësi i enëve/sterilizuesi (për të dezinfektuar lodrat);
- Frigorifer me depo për ruajtjen dhe kyçjen e ilaçeve 609 mm i lartë;
- Tavolina plastike për fëmijë 609 mm, tabelë prej tape (2);
- Tabelë prej tape me kornizë druri (2).

- **Zona aktive**

- Rrëshqitëse për fëmijët;
- Lexues kompakt disk;
- Podium i vogël i mbuluar me tapet (2);
- Podium i madh i mbuluar me tapet(1);
- Vitrinë fotosh (2);
- Raft për fëmijët;
- Dollap për këpucët (2);
- Tunel për të ecur këmbadoras;
- Shkallë e ulët;
- Tub zbulues.

9.3 Dhoma për tre-vjeçarët (mobilie të rekomanduara)
(të gjitha orenditë duhet të jenë anatomike nga forma dhe me materiale antialergjik)

- **Zona e leximit**

- Jastëk për dysheme (1 për fëmijë);
- Tapet me ngjyra të ndezura (2);
- Raft ose vitrinë librash (1);
- Karrige e butë me mbushje (2);
- Vitrinë fotosh (2);
- Divan i vogël për të rritur;
- Njësi biblioteke;
- Tabelë prej cope ngjitëse.

- **Zona e artit/ngrënies**

- Karrocë shërbimi (1);
- Stendë rrobash (2);
- Frigorifer me depo më çelës për ruajtjen e ilaçeve;
- Tavolinë loje me/pa kapak;
- Karrige druri (1 për fëmijë) me lartësi 355 mm;
- Tavolinë e lartë druri (1 për 6 fëmijë) me lartësi 457-508 mm;
- Trekëmbësh i ulët (2);
- Dërrasë e zezë 609 mm e lartë (2);
- Njësi depo prej druri (4);
- Tabelë tape me kornizë druri 914 mm (2).

- **Zona e ndërtimit**

- Dollap muri prej druri (3);
- Blloqe kartoni;
- Kuti lojërash formuese prej druri 609 mm e lartë;
- Dollap druri (3);
- Shtëpi kukulle me/pa mobilie;
- Njësi kompleti blloqesh druri;
- Komplet blloqe formuesesh;
- Komplet treni druri me/pa shina.

TIPE STANDARDE MOBILIESH



KREVAT TIP



TAVOLINE TIP



LAVAMAN TIP



WC TIP

10. IMPIANTISTIKA

Më poshtë jepen një përmbledhje kriteresh teknike të detyrueshme për të përcaktuar kërkesat që janë në bazë të projektimit impiantistik:

Indeks i grumbullimit

Çerdhet	0.4 persona/m²

Kërkesa termoigrometrike

Temperatura ambientale në dimër për çerdhet	21-23°C
Lagështia relative e brendshmenë dimër për çerdhet	34-35%
Temperatura ambientale në verëpër çerdhet	24-26°C
Lagështia relative e brendshmenë dimër për çerdhet	45-50%

Sasia e ajrit të jashtëm ose të ekstraktuar

Çerdhet	14.4 m³/h për person
Zyra	39.6 m³/h për person
Salla polifuksionale	36 m³/h për person
Tualete – shërbime	8 vol/h vetëm ekstraktim

Shpejtësia e ajrit e lejuar

Ngrohje e çerdheve	≤ 0.10 m/s
Ngrohje e ambienteve të tjera	0.05 – 0.15 m/s
Ftohje e çerdheve	≤ 0.10 m/s
Ftohje e ambienteve të tjera	0.05 – 0.20 m/s

Kërkesa ilumino-teknike

Korridoret	50-100-150 lx	dritë e bardhë e ngrohtë
Dhomat	300-500-750 lx	dritë e bardhë e ngrohtë/ e bardhë neutrale
Sallë polifuksionale	150-200-300 lx	dritë e bardhë e ngrohtë/ e bardhë neutrale
Zyra	300-500-750 lx	dritë e bardhë e ngrohtë/ e bardhë neutrale
Shkallë, ashensor	100-150-200 lx	dritë e bardhë e ngrohtë

Tre vlerat e ndriçimint i referohen ndriçimit të përgjithshëm, ndriçimit të orientuar në vendin e aktiviteteve dhe ndriçimit të përqëndruar.

10.1Zgjidhjet impiantistike

10.1.1. Impianti i ngrohjes

Impiantet në çerdhe duhet të garantojnë kushtet klimaterike optimale të përcaktuara më lart. Përsa i përket impiantit të ngrohjes, mund të jetë i tipit miks ajër-ujë.

Një sistem kryesor ventilimi duhet të garantojë këmbimet normale të ajrit ndërkohë që një sistem me radiatorë ose panele radiante do të mundësojë ruajtjen e kushteve të komfortit.
Sistemi i ventilimit, duhet të garantojë një filtrim të ajrit të jashtëm (sidomos nëse struktura është në zona urbane) dhe një trajtim të lagështisë gjithashtu.
Ajri i jashtëm, i filtruar dhe i trajtuar nga ana e lagështisë, mund të futet në çerdhe nëpërmjet një rrjeti kanalizimesh në dukje ose të fshehura nga një tavan i varur. Ekstraktimi i ajrit mund të bëhet direkt me një sistem tëvendosur në shërbimet higjienike ose nëpërmjet një sistemi ekstraktimi të pavarur. Shërbimet higjienike (përfshirë këtu edhe kuzhina) duhet të jenë gjithmonë në depresion në mënyrë që të mos lejojnë daljen e erërave në Mjediset e brendshme të çerdhes. Dyert e shërbimeve higjienike duhet të kenë një grilë tranziti ajrimi.
Duke pasur parasysh që fëmijët në këtë moshë luajnë shumë në dysheme, zgjidhja me panele radiante të zhytura në dysheme gjen një aplikim të pëlqyeshëm. Me këtë zgjidhje dyshmeja do të jetë gjithmonë e ngrohur dhe do të jetë në gjendje të ruajë komoditetin termik.
Në rastin e impiantit me radiator, këta duhet të vendosen në pjesën perimetrale të dhomave në afërsi të strukturave të xhamit. Në rast vendosje radiatorësh duhet të vendosen të maskuara me material veshës për të mos pasur rrezikshmëri për fëmijët. Një zgjidhje e mirë është vendosja e këtyre radiatorëve nën një stol i cili do të shërbente edhe për ulje por edhe për mbështetje të materialeve të ndryshme. Me këtë zgjidhje radiatorët do të siguronin një shpërndarje më uniforme të nxehtësisë, por edhe nuk do të zinin hapësirë dhe mbi të gjitha do të rezultonin të parrezikshëm.
Çerdhet në përgjithësi funksionojnë 5 ditë në javë. Një periudhë kaq e gjatë ftohje të sistemit ka nevojë për një kohë më të gjatë ngrohjeje dhe vënie në regjim të sistemit. Për këtë arsye fuqia kalorifike duhet të llogaritet më e madhe se nevoja.
Për çerdhet në përgjithësi nuk këshillohet një sistem ftohje kondicionimi. Këshillohet që me një impiant të mirë ventilimi të përdoret gjatë natës ajri i freskët, i cili do të garantojë një freskim të bollshëm të mjediseve (free-cooling). Mungesa e impianteve të kondicionimit në verë duhet shoqëruar edhe me një sistem mbrojtje nga dielli, si grila, thyerëse dielli, streha, dritare me xham reflektues etj.

10.1.2. Impianti elektrik

Siguria e fëmijëve dhe zgjerimi i nevojave elektrike duhen marrë gjithmonë parasysh.
Të gjitha të dhënat, pajisjet dhe kërkesat për komunikim duhet të përcaktohen paraprakisht për të parandaluar ndonjë problem më vonë.
Të vendosen priza dupleks në nivelin afërsisht 1500 mm nga niveli i shtruar i dyshemesë.
Të vendosen priza për kuzhinën dhe dhomën e larjes për frigoriferin, sobën, furrën, ngrirësin, furrën ngrohëse, mikrovalën dhe njësitë e larjes/tharjes sipas rastit.
Të ofrohen lidhje elektrike aty ku do të vendosen pajisje nën banakë.
Të ofrohen lidhje elektrike shtesë për monitorim, në hapësirën e përcaktuar për stafin.
Të koordinohen kërkesat dhe të instalohen: dyer të mbyllshme në mënyrë elektrike, alarm sigurie dhe sisteme komunikimi të brendshëm.
Prizat dhe çelësat të kenë një mbrojtje sipas Normave CEI, i cili jepet sipas një kodi **IP** dhe një sekuencë dy numërore. Shifra e parë do të tregojë mbrojtjen *kundër penetrimit të trupave të huaj*, e dyta gradën e mbrojtjes *kundër penetrimit të ujit.*
Tabela e mëposhtme jep disa specifikime teknike më të detajuara për mbrojtjen:

MBROJTJA KUNDËR TRUPAVE SOLIDË TË JASHTËM			MBROJTJA KUNDËR PENETRIMIT		
Shifra e parë	PËRSHKRIMI		Shifra e dytë	PËRSHKRIMI	
0	Jo i mbrojtur		0	Jo i mbrojtur	
1	I mbrojtur kundër trupave të huaj solid me përmasa më të mëdha se 50mm		1	I mbrojtur kundër rënies vertikale të pikave të ujit	
2	I mbrojtur kundër trupave të huaj solid me përmasa më të mëdha se 12mm		2	I mbrojtur kundër rënies së pikave të ujit me kënd rënie 15°	
3	I mbrojtur kundër trupave të huaj solid me përmasa më të mëdha se 25mm		3	I mbrojtur kundër shiut	
4	I mbrojtur kundër trupave të huaj solid me përmasa më të mëdha se 1mm		4	I mbrojtur kundër spërkatjes	
5	I mbrojtur pjesërisht kundër pluhurit		5	I mbrojtur kundër nivelit mesatar të ujit (lagie me ujë)	
6	I mbrojtur totalisht kundër pluhurit		6	I mbrojtur kundër nivelit të lartë të ujit (lagie me ujë)	
			7	I mbrojtur kundër zhytjes totale në ujë	
X	NUK SPECIFIKOHET ASNJË MBROJTJE		X	NUK SPECIFIKOHET ASNJË MBROJTJE	

SHKRONJA E PARË	PËRSHKRIMI SINTETIK	SHKRONJA E PARË	PËRSHKRIMI SINTETIK
A	I mbrojtur kundër aksesit të dorës	H	Aparate me tension të lartë
B	I mbrojtur kundër aksesit të gishtit	M	I provuar nga efektet e dëmshme të ujit kur, pjesët lëvizëse të aparatit janë në lëvizje
C	I mbrojtur kundër aksesit të mjeteve të forta	S	I provuar nga efektet e dëmshme të ujit kur, pjesët lëvizëse të aparatit nuk janë në lëvizje
D	I mbrojtur kundër aksesit të fijeve	Ë	I përshtatshëm në kushte atmosferike speciale dhe i pajisur me mbrojtje shtesë
X	NUK SPECIFIKOHET ASNJË MBROJTJE	X	NUK SPECIFIKOHET ASNJË MBROJTJE

TIPET DHE VENDOSJA E IMPIANTIT		GRADA E MBROJTJES MINIMALE
Zona elektrike të mbyllura	Jashtë	IP23D
	Brenda	IP2X
Kabina elektrike të parafabrikuara		IP23D
Centrale termike me naftë		IP4X
Lavanderi		IP23
Bibliotekë		IP2X
Dhoma		IP3X
Kuzhina		IP24
Tualete		IP24BX

10.1.3. Impianti hidraulik

Për të maksimizuar cilësinë e ujit të pijshëm, duhet të përdoren sisteme të lokalizuara të filtrimit të ujit. Për pajisjet hidraulike duhet të përdoret vetëm lidhje tubash pa plumb, në ato raste kur tubat punojnë me ujin e pijshëm dhe pajisje të tjera që përdoren nga personat në çerdhe.

Kërkesat:

- Të vendosen letra duarsh dhe mbajtëse sapuni në të gjithë lavamanët (përfshirë lavamanët e artit);
- Të vendosen pastrues për tubacionet e mbetjeve që të mund të arrihen lehtë;
- Të vendoset një valvul mbyllje për çdo tubacion në mënyrë që procedurat e mirëmbajtjes të mos ndikojnë pajisjet e tjera hidraulike;
- Të vendosen pileta në tualetet e fëmijëve, dhomat e larjes dhe në çdo dhomë ku përdoret uji;

- Të gjitha pajisjet e ujit të nxehtë që mund të përdorin fëmijët duhet të kenë temperaturë tëkontrolluar që të mos i kalojë 43°C në pikën e daljes së ujit;
- Makina larëse e enëve të lidhet me pajisje të ujit të nxehtë;
- Të vendosen rubineta uji të nxehtë dhe të ftohtë në çdo lavaman;
- Të vendosen rubineta shatërvan me mbrojtje të gojës dhe me hedhje uji me kënd e me lartësi jo më shumë se 550 mm mbi dyshemenë e shtruar;
- Projekti i rubinetit shatërvan nuk duhet të lërë cepa të mprehtë e të rrezikshë;.
- Këto lloje rubinetash duhet të kontrollohen që të mos kontribuojnë në nivele të larta të plumbit dhe asbestit në ujë. Tubacionet e ujit të pijshëm nuk duhet të kenë përmbajtje plumbi (të shihet pjesa mbi lartësitë e lavamanëve dhe tualeteve të montuar);
- Ruajtja e ujit: Përveç kujdesit specifik të çerdheve, të vihen në zbatim teknologji për efikasitetin e ujit dhe strategji po aq efikase për të;
- Të projektohen sisteme të vaditjes dhe ujitjes për të përdorur minimumin apo për të mos përdorur aspak ujë të pijshëm për vaditje;
- Të reduktohet përdorimi i ujit në ndërtesë me minimalisht 20%.
- Të parashikohen depozita uji që do të përdoren në rastet kur ka mungesë uji nga rrjeti kryesor. Depozitat duhet të kenë një kapacitet 30 – 50 litra për fëmijë.

11. AKSESIBILITETI I PAK / BARRIERAT ARKITEKTONIKE

Për një informacion të plotë projektuesit duhet t'i referohen:
Udhëzues në ndihmë të specialistëve projektues dhe zbatues në fushën e ndërtimit
Bazuar në Rregulloren
"Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar"
Miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008.

12. SIGURIA

12.1 Sistemet e sigurisë

Qëllimi i hartimit të masave të sigurisë është të ruajë fëmijët brenda çerdhes, t'i mbrojë ata nga të huajt, dhe t'i mbrojë nga rreziqet sa më shumë të jetë e mundur.
Sistemet do të përfshijnë pajisje, energji elektrike bazë dhe përçues sipas kërkesave. Të gjitha sistemet e alarmit të sigurisë duhet t'i raportojnë sistemit të alarmit apo stacionit qendror të monitorimit në formën e sinjalit zanor apo pamor (apo të dyja). Pajisjet e sistemit të sigurisë mund të përfshijnë, por jo të kufizohen, te: sisteme perimetër të alarmit të sigurisë, mbikëqyrje video për dyert e hyrjes dhe hollin e hyrjes dhe sisteme citofonie për dyert e hyrjes kryesore.

12.1.1 Kërkesa

- Të montohet një kamera te dyert e hyrjes së qendrës. Këto kamera nevojiten kur hyrja e qendrës nuk duket nga personeli i sigurisë së ndërtesës, ose nëse vlerësimi i riskut të sigurisë parashikon monitorim me video të hyrjes. Sistemi me qark të mbyllur duhet të mbulojë hyrjet, daljet dhe zonat e jashtme të lojës.
- Sinjal akustik (zile) te dyert kryesore të hyrjes.

- Të sigurohet me valvul mbylljeje çdo tub në mënyrë që procedurat e mirëmbajtjes të mos ndikojnë impiantet e shumëfishta hidraulike.
- Të vendoset një kuti kontrollesh te porta kryesore (me pozicion dhe butona edhe për persona me aftësi të kufizuara) për të autorizuar hyrjen në çerdhe, pa qenë e nevojshme monitorimi nga ana e personelit. Hyrja duhet të jetë e kontrolluar ose manualisht ose nën kontrollin e personelit të qendrës, ose elektronikisht me karta hyrëse dhe numër kontrolli pin apo mjete të tjera.
- Të gjitha pikat hyrëse duhet të kenë sinjal alarmi dhe duhet të përfshijnë pajisje mbylljeje të vonuar në dyert e daljes. Kyçjet, nëse ka, nuk duhet të kërkojnë çelës, mjete apo njohuri a përpjekje specifike për të dalë në anën tjetër.
- Alarmet e forcimit siç parashikohet nga vlerësimi i sigurisë së ndërtesës, përfshirë alarme forcimi dhe bokse thirrjeje në këndin e lojërave.

12.2 Gardhet dhe zonat e izoluara

Këndet e lojërave duhet të ndahen me gardh, të mundësojnë mbikëqyrjen e fëmijëve dhe t'i mbrojnë ata nga hyrja e paautorizuar e individëve dhe mjeteve të transportit. Për shkak se projektimi i gardhit është një nga elementet më të dukshme të qendrës, ai duhet të jetë edhe më praktiku. Në përgjithësi, nuk duhen përdorur rrjetat e telit si gardh. E vetmja lloj rrjete që mund të përdoret është ajo prej PVC të errët. Teli i galvanizuar ka një pamje mjaft të mirë, por nuk është i përshtatshëm. Nuk duhet të ketë as pjesë të mprehta apo lidhje që mund të dëmtojnë fëmijët.

12.2.1 Kërkesa

- Këndet e lojërave duhet të rrethohen me gardhe për të përcaktuar zonën e lojës, për të mundësuar mbikëqyrjen pamore të fëmijëve, dhe për t'i mbrojtur nga hyrja e individëve dhe mjeteve të paautorizuara.
- Të vendosen shtylla të përforcuara, saksi të ngritura apo mjete të tjera për të mos lënë automjetet të hyjnë në zonën e lojës.
- Kur zona e lojës është afër rreziqeve, rrugëve të ngarkuara, apo është në një lagje me rrezikshmëri të lartë, perimetri i këndit të lojërave duhet të rrethohet me një gardh minimalisht 240cm të lartë.
- Këndi i lojërave duhet të rrethohet nga gardhi, bimë apo mjete të tjera në mënyrë që mos të ketë fushëpamje të plotë të tij.
- Ruajtja e ujit: Përveç elementeve të rëndësishme që duhen marrë në konsideratë për qendrat e kujdesit për fëmijët, duhet të implementohen teknologji për efikasitetin e ujit dhe strategji për të përftuar ujë.
- Të projektohen sisteme të vaditjes dhe mbjelljes për të përdorur minimumin e ujit të pijshëm për vaditjen e bimësisë në oborr.
- Të reduktohet përdorimi i ujit në ndërtesë me minimumin prej 20%
- Fundi i rrjetës së telit duhet të jetë maksimalisht 75 mm lart nga toka. Pjesa e poshtme e ekspozuar mbi tokë duhet të jetë e lëmuar për sigurinë e fëmijëve.
- Portat duhet të mbyllen vetë dhe të jenë të sigurta mjaftueshëm që gishtat e fëmijëve të mos ngecin te hapësirat mes tyre.
- Përveç pjesës së poshtme dhe të sipërme të gardhit, të mos përdoren elemente horizontale që mund të shërbejnë si shkallë për t'u ngjitur. Të gjitha elementet lidhëse që përdoren

për ndërtimin e gardhit nuk duhet të projektohen për nga jashtë, duke u kthyer kështu në rreziqe për fëmijët.
- Të priten ose krasiten degët e poshtme të pemëve nëse këto rrezikojnë të përdoren për të kaluar në anën tjetër të gardhit.
- Degët, në asnjë rast nuk duhet të shkojnë në lartësinë 20-30 mm mbi tokë.

12.3 Shkallët në çerdhe

Për projektimin e shkallëve në cerdhe duhet të kihen parasysh këto elemente të sigurisë:

1. Shkallët në të dyja anët duhet të kenë mbajtëse (parmak) me dy nivele të ndryshme. Një nivel për të rriturit (kujdestaret, prindër, etj,…) me lartësi 0.9m dhe një nivel për fëmijët me lartësi 0.65m.

2. Shkallët duhet të kenë parapet të plotë muri ose materiali tjetër, deri në lartësinë 0.65m.

3. Lartësia shkallës nga midis dy sipërfaqeve të shkelshme të jetë jo më shumë se 0.10m

4. Gjerësia e shkallëve varion nga 1 deri në 1.3 m.

5. Hapësira e shkeljes të jetë jo më shumë se 0.26m

6. Hapësira e shkeljes të trajtohet me material kundër rrëshqitjeve

Për elemente të tjera të projektimit të shkallëve referohuni VKM. Nr, 626, Dt. 15.07.2015 "Normativat e projektimit të banesave".
Për personat me aftësi të kufizuar referohuni VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores " Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar" .

Bibliografia:

- VKM nr.98, Dt. 06.02.2013, "Për miratimin e listës së Standardeve të Harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit për produktet e ndërtimit
- Normat ISO për ndërtimet.
- VKM, Nr. 68, datë 15.2.2001, Për "Miratimin e Standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit".
- VKM, Nr. 1503, Dt. 19.11.2008, Për miratimin e rregullores " Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar".
- Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr. 425, Dt. 24.07.2015 "Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe për shëptimin dhe lëshimin e akteve teknike"
- Urdhër i Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr. 424, Dt. 24.07.2015 "Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim".
- Ligji, Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".
- Ligji, Nr.107/2014, Dt. 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit"
- VKM. Nr. 408, Dt. 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit".
- VKM. Nr, 626, Dt. 15.07.2015 "Normativat e projektimit të banesave".
- VKM. Nr, 628, Dt. 15.07.2015 "Rregullat teknike të projektimit dhe të ndërtimit të rrugëve".
- VKM. Nr, 691, Dt. 29.07.2015 "Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore".
- Rregullore Higjieno-Sanitare Nr.379. Dt.16.12.1994 "Për Ndërtimin dhe Funksionimin e Cerdheve të Fëmijëve"
- DECRETO 16 luglio 2014 "Regola tecnica di prevenzione incendi per la progettazione, costruzione ed esercizio degli asili nido". (14A05976)
(GU n.174 del 29-7-2014)
- Linee guida per la progettazione di un asilo nido

(Estratto del Capitolato Tipo per la costruzione di asili nido approvato con DD.G.R. nn. 54-3346 del 8.06.1975 e 77-3869 del 7.07.1976)

- Zevi, B. Architectura-Zevi, Il Nuovissimo Manuale Dell Architetto.
- Neufert, E. & P. Architectural Standard

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 1008 lekë